

B a n k a e S h q i p ë r i s ë

2 0 0 0 7

BULETINI
I BILANCIT TË PAGESAVE

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.
Tel: 355-4-2222230; 2222152; 2235569;
Faks: 355-4-2223558
e-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Për informacione lidhur me këtë publikim, lutemi kontaktoni:
Sektori i Botimeve, Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Evropian dhe
Komunikimit.
E-mail: public@bankofalbania.org

Tirazhi: 1200 kopje

P Ë R M B A J T J A

1. ZHVILLIME TË PËRGJITHSHME NË BILANCIN E PAGESAVE GJATË VITIT 2007	7
1.1 TREGUES TË SEKTORIT TË JASHTËM	9
1.2 LLOGARIA KORENTE	10
1.3 LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE	22
1.4 REZERVAT VALUTORE	25
1.5 POZICIONI I INVESTIMEVE NDËRKOMBËTARE DHE BORXHI I JASHTËM	25
2. ANEKS	30
2.1 POLITIKA TREGTARE TË SHQIPËRISË	30
2.2 MATJA E SHËRBIMEVE TË UDHËTIMIT, PËR VITIN 2007	32
3. ANEKS METODOLOGJIK	40
4. ANEKS STATISTIKOR	44

P Ë R M B A J T J A E T A B E L A V E

1. Zhvillime të përgjithshme në bilancin e pagesave gjatë vitit 2007	
Tabelë 1. Treguesit kryesorë të bilancit të pagesave në raport ndaj PBB-së.	9
Tabelë 2. Tregtia e mallrave.	11
Tabelë 3. Eksporti sipas klasifikimit SITC.	13
Tabelë 4. Importi sipas klasifikimit SITC.	13
Tabelë 5. Shpërndarja e eksporteve sipas partnerëve tregtarë në vite.	16
Tabelë 6. Shpërndarja e importeve sipas partnerëve tregtarë në vite.	17
Tabelë 7. Struktura e importit dhe eksportit të shërbimeve.	18
Tabelë 8. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve të Shqipërisë (në fund të periudhës, në milionë euro).	26
Tabelë 9. Përbërja e mjeteve të huaja, në milionë euro.	26
Tabelë 10. Përbërja e detyrimeve të huaja, në milionë euro.	27
Tabelë 11. Stoku i borxhit të jashtëm bruto sipas sektorëve (në fund të periudhave, në miliardë euro dhe në përqindje).	28

P Ë R M B A J T J A E G R A F I K Ë V E

1. Zhvillime të përgjithshme në bilancin e pagesave gjatë vitit 2007	
Grafik 1. Deficiti korent në përqindje ndaj PBB-së.	7
Grafik 2. Shpërndarja e të ardhurave dhe shpenzimeve në llogarinë korente.	10
Grafik 3. Divergjenca në eksporte dhe importe (ritmet e rritjes vjetore).	12
Grafik 4. Ecuria e lëndëve djegëse në vite.	14
Grafik 5. Kontributi në ndryshimin e totalit të importeve.	15
Grafik 6. Kontributi i tregtisë nga përpunimi aktiv në vëllimin e përgjithshëm tregtar.	16
Grafik 7. Bilanci i shërbimeve-fluksi neto në milionë euro.	18
Grafik 8. Rritja vjetore në importe dhe eksporte shërbimesh.	18
Grafik 9. Ecuria e eksportit të mallrave dhe e rritjes relative të eksportit udhëtime/mallra.	19
Grafik 10. Shpenzimet për turizëm ndaj fluksit hyrës të remitançave.	19
Grafik 11. Bilanci i të ardhurave (në milionë euro).	22
Grafik 12. Ecuria e dërgesave të emigrantëve (në milionë euro).	22
Grafik 13. Llogaria financiare në vite fluksi neto në milionë euro.	23
Grafik 14. Financimi i deficitit korent nëpërmjet investimeve të huaja direkte.	24
Grafik 15. Rezerva valutore në muaj importe.	25
Grafik 16. Ecuria e stokut të borxhit të jashtëm bruto (në fund të periudhave, në miliardë euro).	27
Grafik 17. Struktura e borxhit të jashtëm sipas monedhës (në fund të vitit 2007).	28
Grafik 18. Raportet e borxhit të jashtëm bruto si përqindje ndaj PBB-së dhe eksporteve.	29
2. Aneks	
Grafik 19. Fluksi hyrës dhe dalës i jorezidentëve dhe rezidentëve në tremujorë, gjatë viteve 2004-2007.	36
Grafik 20. Shpërndarja e jorezidentëve, sipas vendit të origjinës.	36
Grafik 21. Shpërndarja e rezidentëve, sipas destinacionit të udhëtimit.	36
Grafik 22. Shpërndarja e jorezidentëve dhe rezidentëve, sipas qëllimit të udhëtimit.	37
Grafik 23. Shpërndarja e jorezidentëve dhe rezidentëve, sipas akomodimit në vendin e vizituar.	37
Grafik 24. Kohëqëndrimi për jorezidentët dhe rezidentët sipas qëllimit të udhëtimit, në tremujorë, për vitet 2004-2007.	37
Grafik 25. Shpenzimet mesatare ditore për jorezidentët dhe rezidentët sipas qëllimit të udhëtimit në tremujorë, për vitet 2004-2007.	38
Grafik 26. Struktura e shpenzimeve të kryera nga rezidentët dhe jorezidentët.	39

1. ZHVILLIME TË PËRGJITHSHME NË BILANCIN E PAGESAVE GJATË VITIT 2007

Sektori i jashtëm i ekonomisë, gjatë vitit 2007 është karakterizuar nga një fluks i madh i shkëmbimeve tregtare, me një vëllim të përgjithshëm prej 3.7 miliardë eurosh, i vlerësuar ky 26 për qind më i lartë se ai i vitit paraardhës. Deficiti tregtar arriti vlerën e 2.1 miliardë eurove ose 27 për qind më i lartë se viti 2006, më i larti i regjistruar në vite. Treguesi relativ i deficitit korent ndaj PBB-së, ka arritur në 10.7 për qind nga 6.5 për qind i vlerësuar për vitin 2006.

Deficiti tregtar ka përbërë një tipar të përhershëm të zhvillimeve të tregtisë së jashtme, duke diktuar nivelet e larta të deficitit të llogarisë korente. Kërkesa e lartë për importe, për nevoja të rritjes ekonomike dhe njëkohësisht për të plotësuar nevojat e popullsisë në mallra konsumi, ka evidentuar dukshëm zgjerimin e bazës së importeve në vite.


Shkalla e hapjes ekonomike të Shqipërisë është përmirësuar në 84 për qind nga 72 për qind në vitin e kaluar. Por, ajo mbetet në nivele mjaft të ulëta në raport me ekonomitë e rajonit.

Ndonëse tregtia në mallra (kryesisht importet) është dominuese, tregtia e shërbimeve duket se po zë një peshë të konsiderueshme në hapjen ekonomike. Këto shërbime përfaqësohen kryesisht nga shërbimet e udhëtimit, gjë që tregon përparësinë konkurruese të ekonomisë tonë në tregtinë ndërkombëtare të shërbimeve.

Rritja e shkallës së hapjes ekonomike do të ishte më inkurajuese nëse do të kishim më shumë përfaqësi në eksportet tona. Edhe pse importet kanë qenë vendimtare në këtë rritje, përsëri mund të konsiderohet si një zhvillim pozitiv. Kjo sepse rritja e tyre këtë vit, buron kryesisht nga importe produktive dhe më pak nga ato joproduktive.

Në të njëjtën kohë, eksporti i mallrave ka përshpejtuar ritmet e rritjes me 25 për qind. Ky është tregues për një rritje të aftësive konkurruese, në sektorin e industrisë përpunuese, pasi marrëveshjet e tregtisë së lirë me vendet e Evropës

Grafik 1. Deficiti korent në përqindje ndaj PBB-së.



Juglindore¹, CEFTA, si dhe marrëveshja e tregtisë së lirë me Bashkimin Evropian, INTERIM² kanë ndihmuar kompanitë me orientim eksporti, të hyjnë në tregjet ndërkombëtare dhe të përballen me standardet e tyre. Eksporti i shërbimeve, i cili vlerësohet të ketë tejkaluar importin e kësaj kategorie me 13 milionë euro, ka përcaktuar përparësinë krahasuese të ekonomisë shqiptare në tregjet ndërkombëtare.

Për vitin 2007, rritja e importeve vjen si bashkërrjedhojë e disa faktorëve të jashtëm – rritja e pazakontë e çmimeve të naftës si dhe rritja e çmimeve të disa produkteve në tregjet ndërkombëtare; dhe faktorëve të brendshëm – situata e përkeqësuar energjitike në vend, e cila çoi në importe të larta në energji elektrike.

Treguesi relativ i importeve ndaj PBB-së, për vitin 2007 vlerësohet në rreth 37.4 për qind nga 31.3, në vitin 2006.

Eksporti (në mallra dhe shërbime) u rrit me rreth 23 për qind krahasimisht me një vit më parë dhe vetëm 2 për qind e tij ka shërbyer borxhin e jashtëm³, i cili konsiderohet larg nivelit prej 25 për qind, që njihet përgjithësisht si nivel kritik i pagueshmërisë.

Hyrjet e konsiderueshme në formën e transfertave korente në vite, kanë ndihmuar në zbutjen e deficiteve të larta tregtare, duke çuar në lehtësimin e pozicionit të bilancit të pagesave. Gjatë vitit 2007, fluksi neto i transfertave korente arriti në rreth 1 miliard euro, nga të cilat rreth 91 për qind janë kontribut i emigracionit shqiptar. Këto dërgesa vlerësohen rreth 12.3 për qind të PBB-së me rënie të lehtë prej 6 pikë përqindjeje, kundrejt vitit 2006.

Nga ana tjetër, financimi i deficitit korent të këtij viti ka qenë pothuaj plotësisht i mundur nëpërmjet flukseve hyrëse të kapitalit të huaj në formën e transfertave kapitale, si dhe flukseve financiare në formën e investimeve të huaja direkte, huamarrjes me jashtë dhe investimeve të tjera afatshkurtra.

Financimi i deficitit të vazhdueshëm korent nëpërmjet investimeve direkte shihet si investim i qëndrueshëm, me përfitime teknologjike dhe njohurish, si dhe më të sigurt për ekonominë. Ndërkohë, financimi nëpërmjet huamarrjes me jashtë, ndonëse në periudha afatshkurtra lehtëson pozicionin e jashtëm të vendit, përgjithësisht trajtohet si një strategji me rrezik. Megjithatë, Shqipëria nuk është në prag të ballafaqimit me aftësi paguese të borxhit të jashtëm, duke u vlerësuar në nivele modeste edhe për një periudhë afatshkurtër.

Flukset hyrëse të kapitalit, bënë që bilanci i përgjithshëm i pagesave për vitin 2007 të mbyllet me suficit prej rreth 148.6 milionë eurosh, me një rënie vjetore prej 28 për qind. Ky suficit në bilancin e përgjithshëm, ka çuar në rritje të rezervave valutore, të cilat në fund të vitit 2007 u vlerësuan në rreth 1.5 miliardë euro.

Gjithashtu, detyrimet neto që rrjedhin prej investimeve ndërkombëtare në Shqipëri (pozicioni ndërkombëtar i investimeve), arritën në 1.2 miliardë euro

(rreth 15 për qind e PBB-së). Pozicioni neto debitor i Shqipërisë paraqitet në fund të vitit 2007, rreth 2.2 herë më i lartë se ai i fundvitit 2006. Ndërkohë, shkalla e hapjes së ekonomisë shqiptare në tregun financiar ndërkombëtar, e shprehur në terma të PBB-së, është rreth 76.4 për qind.

Së fundmi, një tregues kritik i sektorit të jashtëm është mjaftueshmëria e rezervave të autoritetit monetar. Kështu, raporti i mbulimit të importeve, që mat aftësinë e ekonomisë për të plotësuar nevojat e saj për importe (të mallrave dhe shërbimeve), vlerësohet në 4.2 muaj importe dhe përbën një nivel të kënaqshëm.

	2005	2006	2007	2005	2006	2007
	në milionë euro			në përqindje ndaj PBB-së		
Llogaria korente	(589.1)	(471.0)	(831.5)	8.7	6.5	10.7
Bilanci tregtar	(1,476.7)	(1,658.9)	(2,104.0)	21.8	22.7	27.2
Eksport	530.2	630.6	786.3	7.8	8.6	10.2
Import	(2,006.9)	(2,289.6)	(2,890.4)	29.6	31.3	37.4
Shërbime (neto)	140.4	(31.5)	12.9	2.1	0.4	0.2
Të ardhura (neto)	131.2	208.8	216.8	1.9	2.9	2.8
Transferta korente (neto)	896.9	1,010.6	1,042.9	13.2	13.8	13.5
Llogaria kapitale (neto)	451.0	558.4	830.2	6.7	7.6	10.7
Bilanci i përgjithshëm	124.8	206.6	148.6	1.8	2.8	1.9

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Treguesit kryesorë të bilancit të pagesave në raport ndaj PBB-së.

1.1 TREGUES TË SEKTORIT TË JASHTËM

Shumë tregues - kyç të bilancit të pagesave, dëshmojnë për përmirësim gjatë vitit 2007, ndonëse në tregues të tjerë shfaqen disa dobësi.

Shkalla e hapjes tregtare⁴ të Shqipërisë është vlerësuar në 49.5 për qind nga 41.8 për qind në vitin e kaluar, ndonëse mbetet në nivele mjaft të ulëta në raport me ekonomitë e rajonit. Ndërkohë, shkalla e hapjes ekonomike⁵ të Shqipërisë është përmirësuar me 10 pikë përqindje kundrejt vitit të kaluar dhe vlerësohet 84 për qind. Duke marrë parasysh lidhjen midis hapjes tregtare dhe rritjes ekonomike, rritja e hapjes tregtare të vendit është një zhvillim i mirëpritur. Megjithatë, një zhvillim i tillë do të ishte më inkurajues nëse do të buronte më shumë nga eksportet, përderisa kompanitë me orientim eksporti, duke u përballur me konkurrencën e fortë ndërkombëtare, janë shpesh më eficiente. Por edhe këtë vit, megjithë përshejtimin në rritjen e eksporteve, rritja e këtij treguesi ka ardhur në masën më të madhe nga importet. Gjatë vitit 2007, eksporti (në mallra dhe shërbime) u rrit me rreth 23 për qind krahasimisht me një vit më parë.

Shërbimi i borxhit të jashtëm vlerësohet në nivele modeste, duke arritur në rreth 2 për qind të totalit të eksporteve ose shumë poshtë nivelit prej 25 për qind, të konsideruar përgjithësisht si nivel kritik.

Roli i importeve, përveç ndikimit pozitiv në rritjen e treguesit të hapjes tregtare, ka pasur edhe ndikimin e tij negativ, në raportin e deficitit korent

ndaj PBB-së, tregues ky i qëndrueshmërisë së deficitit korent. Si pasojë e rritjes së madhe në importe, ky raport është përkeqësuar gjatë dy viteve të fundit. Deficiti korent, pa transfertat zyrtare, për vitin 2007 u vlerësua rreth 11.5 për qind nga 7 për qind në vitin paraardhës.

Treguesi relativ i investimeve të huaja direkte ndaj PBB-së u vlerësua në 6.2 për qind, me një rritje prej rreth 74 për qind kundrejt një viti më parë, rritje kjo kryesisht e ardhur nga efekti i privatizimit. Ky raport vazhdon të konsiderohet në nivele të ulëta krahasuar me ekonomitë e rajonit.


Së fundmi, një tregues kritik i sektorit të jashtëm është mjaftueshmëria e rezervave për shembull, raporti i mbulimit të importeve, që mat aftësinë e ekonomisë për të plotësuar nevojat e saj për importe (të mallrave dhe shërbimeve) nëpërmjet rezervave të saj. Për vitin 2007, ky raport vlerësohet në 4.2 muaj importe dhe përbën një nivel të kënaqshëm⁶.

1.2 LLOGARIA KORENTE

Viti 2007 karakterizohet nga rritje intensive e transaksioneve korente me pjesën tjetër të botës. Vëllimi i transaksioneve korente është rritur me rreth 20 për qind krahasuar me vitin 2006, duke shënuar një nivel prej 8.2 miliardë eurosh, nga të cilat 55 për qind kanë shkuar për shpenzime korente.

Mëse 95 për qind e shpenzimeve korente kanë shkuar për blerje mallrash dhe shërbimesh. Ndërkohë, 60 për qind e të ardhurave korente janë siguruar nga eksportet e mallrave dhe shërbimeve, dhe pjesa tjetër ka ardhur në formën e transferave korente (33 për qind), të ardhurave nga puna dhe nga investimet (7.5 për qind).

Grafik 2. Shpërndarja e të ardhurave dhe shpenzimeve në llogarinë korente.



Deficiti korent për vitin 2007, u vlerësua në nivelin 831.5 milionë euro, me një rritje prej rreth 77 për qind kundrejt vitit 2006, duke qenë i barazvlefshëm

me rreth 10.7 për qind të PBB-së. Deficiti i lartë tregtar që ka karakterizuar zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë gjatë këtij viti, ka neutralizuar efektet pozitive të tregtisë së shërbimeve si dhe rritjen e flukseve pozitive në të ardhurat faktoriale neto, duke mbetur shkaktari kryesor në thellimin e deficitit korent për këtë periudhë.

Llogaria e shërbimeve gjatë këtij viti ka regjistruar rritje si në kahun e të ardhurave, ashtu edhe në atë të shpenzimeve. Në krahasim me vitin 2006, të ardhurat janë rritur më shpejt sesa shpenzimet. Për rrjedhojë, rezultati neto i transaksioneve në shërbime ka çuar në një bilanc pozitiv të kësaj llogarie, me rreth 13 milionë euro.

Bilanci pozitiv i hyrjeve korente në formën e transfertave dhe të të ardhurave, vlerësohet të jetë rreth 40 milionë euro më i lartë, krahasuar me vitin e kaluar. Një zhvillim i tillë, i dedikohet kryesisht rritjes së transfertave korente, ku peshën më të madhe e zënë transfertat zyrtare me rreth 18 milionë euro. Ndërkohë që ato private (dërgesat nga emigrantët), kanë pësuar një rritje të lehtë në rënie.

1.2.1 TREGTIA E JASHTME

Fluksi i madh i shkëmbimeve tregtare që karakterizoi vitin 2007, rezultoi me një vëllim të përgjithshëm tregtar prej 3.8 miliardë eurosh, i vlerësuar ky 25 për qind më i lartë se viti paraardhës. Kontributi i tregtisë së mallrave në llogarinë korente mbetet në nivele të larta, rreth 47 për qind e të gjitha transaksioneve korente.

Intensifikimi i aktivitetit tregtar ishte reflektim i një sërë faktorëve ku mund të veçojmë rritjen e përgjithshme të çmimeve, luhatjet e kursit të këmbimit si dhe uljen graduale të tarifave doganore, pjesë e proceseve liberalizuese tregtare.


	Njësia	2005	2006	2007
Eksportet (F.O.B)	mln euro	530.2	630.6	786.3
Importet (C.I.F)	mln euro	2,006.9	2,410.9	3,044.7
Bilanci tregtar	mln euro	(1,476.7)	(1,780.3)	(2,258.4)
Vëllimi tregtar	mln euro	2,510.1	3,041.5	3,831.0
Rritja e eksporteve (kundrejt vitit paraardhës)	%	9.2	18.9	24.7
Rritja e importeve (kundrejt vitit paraardhës)	%	13.8	20.1	26.3
Eksportet/PBB	%	7.8	8.6	10.2
Importet/PBB	%	29.6	33.0	39.4
Bilanci tregtar/PBB	%	21.8	24.4	29.2
Shkalla e mbulimit të importeve nga eksportet	%	25.4	26.2	25.8
Shkalla e hapjes tregtare	%	37.5	41.8	49.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 2. Tregtia e mallrave.

Importet vazhdojnë të përbëjnë kahun dërrmues të rrjedhjes së shkëmbimeve tregtare të Shqipërisë me botën, duke përfaqësuar mëse 79 për qind të vëllimit tregtar.

Grafik 3. Divergjenca në eksporte dhe importe (ritmet e rritjes vjetore).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Dinamika e tregtisë na flet për ritme të larta rritëse si në importe (26 për qind) ashtu edhe në eksporte (25 për qind). Megjithatë, baza e ulët e këtyre të fundit nuk mundi të ndikojë në përmirësimin e deficitit tregtar. Ai arriti vlerën e 2.3 miliardë eurove ose 27 për qind më i lartë se viti 2006.

Kapaciteti prodhues në vend, i pamjaftueshëm për të kënaqur kërkesën gjithmonë e në rritje të ekonomisë shqiptare për mallra, ka bërë që raporti i mbulimit të importeve nga eksportet prej 25.8 për qind, të mbetet në nivelet e viteve të fundit.

Gjithashtu, kontributi i eksporteve në PBB edhe këtë vit ka rezultuar 10.2 për qind, lehtësisht i përmirësuar në krahasim me një vit më parë.

• EKSPORTI I MALLRAVE

Eksportet tona shfaqin shpërndarje jopërpjestimore midis sektorit të industrisë përpunuese (përpunimi aktiv) dhe atij të brendshëm. Industria përpunuese përfaqëson 93 për qind të totalit të eksporteve. Eksportet e saj vlerësohen 26 për qind më të larta se ato të vitit paraardhës. Varësia e theksuar e eksporteve tona nga përpunimi aktiv në industrinë e tekstileve dhe këpucëve vazhdon të karakterizojë edhe këtë vit, duke kontribuar me 48 për qind në totalin e tyre.

Ndërsa, eksporti i brendshëm është rritur me 14 për qind, i përqendruar kryesisht në ushqime të përgatitura të mishit, peshkut dhe në farat vajore.

Grupmali që shfaq rritjen më të madhe, gjatë vitit 2007, ishin lëndët djegëse (130 për qind) duke përfaqësuar rreth 8 për qind të totalit të eksporteve. Eksportet e naftës së papërpunuar, përbëjnë 72 për qind të lëndëve djegëse.

Ndërkohë që, oferta vendase për këtë grupmall po shfaq një prirje rritëse mjaft të mprehtë gjatë 3-4 viteve të fundit. Destinacioni kryesor janë fabrikat rafinuese në vendin fqinjë, Itali.

Eksporti i produkteve minerale u vlerësua 3 herë më i lartë se në vitin paraardhës. Kontributin më të madh në këtë rritje e dhanë eksportet e kromit me tregje të përqendruara drejt Kinës dhe Suedisë. Eksporti i aluminit dhe i artikujve të tij u rrit rreth 1.5 herë në terma nominalë, duke kontribuar në rritjen vjetore të totalit të eksportit me rreth 10 për qind. Gjithashtu, eksporti i plumbit dhe i artikujve të tij, pati ndikim në rritjen e eksportit të mineraleve. Eksporti i këtij grupmali u rrit rreth 2 herë si në terma nominalë ashtu edhe në sasi.

Tabelë 3. Eksporti sipas klasifikimit SITC.

Kodi	Përshkrimi	2005	2006	2007	2005	2006	2007	2007/2006
		Vlera në milionë euro			Struktura në %			Ndryshimi në %
0	Ushqime dhe kafshë të gjalla	20.4	26.8	28.4	3.9	4.2	3.6	6.2
1	Pije dhe duhan	9.6	8.3	11.0	1.8	1.3	1.4	32.4
2	Materiale të papërpunuara	25.6	34.9	75.6	4.8	5.5	9.6	116.9
3	Lëndë djegëse	15.4	27.3	62.5	2.9	4.3	7.9	129.1
4	Yndyrna bimore dhe shtazore	0.2	0.5	0.7	0.0	0.1	0.1	61.1
5	Produkte kimike	4.8	6.2	8.2	0.9	1.0	1.0	32.1
6	Mallra të përpunuar	114.3	141.5	167.4	21.6	22.4	21.3	18.3
7	Makineri dhe pajisje	22.1	24.5	33.1	4.2	3.9	4.2	34.9
8	Mallra të tjerë të përpunuar	317.7	360.8	399.4	59.9	57.2	50.8	10.7
9	Mallra të paklasifikuar diku tjetër	-	-	-	-	-	-	-
	TOTALI	530.2	630.6	786.3	100.0	100.0	100.0	24.7

Burimi: Banka e Shqipërisë.

- **IMPORTI I MALLRAVE**

Rritja e vazhdueshme e çmimit të naftës dhe importet e larta në energji elektrike, të shoqëruara me kërkesën për mallra të ndërmjetëm dhe ata kapitalë, përbëjnë faktorët kryesorë në rritjen e importeve edhe gjatë vitit 2007.

Përmbushja e kërkesave të brendshme me energji elektrike, kushtet jo të favorshme klimatike si dhe rritja e çmimit të energjisë - duke pasuar zhvillimet në çmimin e naftës - (shih hapësirën informuese 1), kanë gjashtëfishuar shpenzimet në importet e kësaj kategorie. Sasia e importuar e energjisë pati një rritje të ndjeshme me rreth 3.6 herë krahasuar me një vit më parë, duke përfaqësuar rreth 6 për qind të totalit të importeve. Po kështu, importi i karburanteve dhe i naftës rezultoi 75 për qind më i lartë se në vitin 2006.

Rritja e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare ka pasur efektin domino në çmimet e mallrave të importuar nga ekonomia shqiptare.

Tabelë 4. Importi sipas klasifikimit SITC.

Kodi	Përshkrimi	2005	2006	2007	2005	2006	2007	2007/2006
		Vlera në milionë euro			Struktura në %			Ndryshimi në %
0	Ushqime dhe kafshë të gjalla	272.33	320.9	379.3	13.1	13.3	12.5	18.2
1	Pije dhe duhan	64.71	77.3	89.4	3.1	3.2	2.9	15.6
2	Materiale të papërpunuara	75.91	86.1	68.2	3.6	3.6	2.2	(20.8)
3	Lëndë djegëse	181.77	254.9	446.4	8.7	10.6	14.7	75.1
4	Yndyrna bimore dhe shtazore	28.50	31.5	34.0	1.4	1.3	1.1	7.7
5	Produkte kimike	201.75	252.5	302.2	9.7	10.5	9.9	19.7
6	Mallra të përpunuar	509.85	618.2	754.9	24.5	25.6	24.8	22.1
7	Makineri dhe pajisje	488.97	484.7	630.9	23.5	20.1	20.7	30.2
8	Mallra të tjerë të përpunuar	260.07	284.7	339.5	12.5	11.8	11.2	19.2
9	Mallra të paklasifikuar diku tjetër	-	-	-	-	-	-	-
	TOTALI	2,083.85	2,410.9	3,044.7	100.0	100.0	100.0	26.3

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kërkesa e lartë e këtyre viteve të fundit për produkte farmaceutike, ndikuar edhe nga zhvillimet botërore në këtë kategori⁷, ka sjellë rritje të konsiderueshme

të importit të produkteve kimike, prej 19.7 për qind krahasuar me një vit më parë.

Vërehet një prirje rritëse e importeve të produkteve bujqësore. Gjatë vitit 2007 ato kanë qenë 17 për qind më të larta, ku impaktin më të madh e dhanë produktet vegjetale.

Zgjerimi i konsiderueshëm, gjatë vitit 2007, i grupmallrave si produktet minerale, makineri dhe pajisje, metalet bazë dhe artikuj të tyre, ka ardhur si rrjedhojë e plotësimit në vend të nevojave të sektorit ndërtues, atij energjistik, telekomunikacionit si dhe e investimeve në infrastrukturë. Financimi i këtyre sektorëve të ekonomisë ka ardhur më së tepërmi nga kreditimi i tyre, prej bankave të nivelit të dytë gjatë vitit 2007. Rreth 60 për qind e këtyre kredive kanë shkuar për investime në ndërtim, tregti, automjete dhe pajisje shtëpiake. Shpenzimet për import të grupmallit të produkteve minerale si dhe atij të makinerive dhe pajisjeve, janë vlerësuar respektivisht me 51 për qind dhe 30 për qind më të larta se viti i kaluar. Ndërkohë që, metalet bazë renditen si grupmali i tretë më shumë i importuar. 66 për qind e këtyre të fundit e përfaqësojnë importet e hekurit dhe çelikut. Është e qartë që këta grupmallra kërkojnë një konsum më të lartë të karburanteve, arsye kjo që shpjegon dhe rritjen e shpenzimeve për import të lëndëve djegëse.

Sasia e karburanteve të importuara gjatë vitit 2007 u vlerësua 18 për qind më e lartë se ajo e vitit paraardhës, duke përfaqësuar 9 për qind të totalit të importeve.


Hapësirë informuese 1. Karburantet - zhvillime botërore dhe ndikime në tregtinë e jashtme.

Ekonomia botërore nga viti në vit gjendet përballë fenomenit të shumëpërfolur të pakësimit të burimeve natyrore të karburanteve dhe manipulimit me çmimet e tyre. Trazirat dhe mungesa e stabilitetit në Lindjen e Mesme si dhe lufta në Irak bënë që rajoni më i madh i prodhimit të karburanteve, të zvogëlojë eksportin e tyre. Pothuajse të gjitha këto vende pësuan rënie në prodhimin e ri të karburanteve. Çmimi i shitjes së naftës arriti pikun e tij për vitin 2007, në dhjetor, kur çmimi i shitjes së një fuçje naftë shkoi në 98 usd, 20 usd më i lartë se pikun e vitit 2006.

Zëri karburante dhe lubrifikante pësoi një rritje të ndjeshme prej rreth 75 për qind në krahasim me vitin paraardhës, duke përfaqësuar kështu 15 për qind të totalit të shpenzimeve për import të vendit tonë.

Vendi ynë ka njohur një rritje të lartë në kërkesën për karburante gjatë vitit 2007. Pikërisht, sasia e karburanteve të importuara gjatë këtij viti u vlerësua 18 për qind më e lartë se viti paraardhës, duke përfaqësuar 9 për qind të totalit të importeve.

Grafik 4. Ecuria e lëndëve djegëse në vite.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kriza energjitike, e shkaktuar nga ndërprerja e furnizimeve me gaz nga Rusia, kushtëzoi nivele të larta të çmimit të energjisë elektrike. Gjatë vitit 2007, importet kryesore të energjisë elektrike janë nga Zvicra, Serbia dhe Mai i Zi duke zënë 81 për qind të totalit të importeve të energjisë elektrike.

Çmimet e larta të karburanteve dhe energjisë sjellin rritjen e kostos së prodhimit të mallrave, duke ndikuar drejtpërdrejt në nivelin e çmimeve dhe në inflacion.

Hapësirë informuese 2. Përpilimi dhe analiza e importeve sipas BEC.

Për analiza më të agreguara të tregtisë së jashtme, na vjen në ndihmë klasifikimi sipas kategorive të gjera ekonomike (BEC), që tashmë aplikohet në të dhënat e tregtisë së jashtme që prej vitit 2003.

BEC klasifikon produktet duke u bazuar në Klasifikimin Standard të Tregtisë së Jashtme (SITC), së pari sipas natyrës së tyre (të dorës së parë ose të dorës së dytë) dhe së dyti, sipas qëllimit përfundimtar të përdorimit. Nëpërmjet këtij klasifikimi ne arrijmë të masim rëndësinë e ndarjes së proceseve të prodhimit. Ky lloj klasifikimi dallon 19 kategori bazë, të cilat në harmoni me statistikat kombëtare përmbledhen në 3 grupe të mëdha: mallra kapitalë, mallra të ndërmjetëm dhe mallra konsumi.

Në një analizë të importeve sipas përdorimit të tyre përfundimtar, vërejmë një përqendrim të theksuar drejt mallrave të ndërmjetëm (53 për qind). Ndërkohë që mallrat kapitalë dhe ata të konsumit, përfaqësojnë përkatësisht 30 për qind dhe 14 për qind të totalit të importit, gjatë vitit 2007. Mallrat e ndërmjetëm, përfaqësohen konsiderueshëm nga mallrat industriale të përpunuar (60 për qind), si dhe lëndë djegëse për qëllime industriale.


Vlen për t'u theksuar se destinacioni i të ardhurave të konsumatorëve vendas, po zhvendoset nga konsumi drejt kursimit apo investimit. Pikërisht, mallrat e konsumit janë ulur me 7 pikë në nivel përfaqësues krahasuar me vitin 2006, ndërkohë që rritjen më të ndjeshme e kanë pasur mallrat kapitalë (36 për qind).

Industria përpunuese në vend vazhdon të përbëjë pjesën dërrmuese të transaksioneve tregtare të vendit tonë. Importet për lëndë të parë përfaqësojnë 13 për qind të totalit, ndërkohë që 67 për qind e të ardhurave nga eksporti ishin rezultat i rieksperteve. Suficiti që shoqëron këtë industri prej vitësh, në vlerë absolute u vlerësua 120 milionë euro.

	2005	2006	2007	2007/2006
			Struktura në %	Ndryshimi në %
Mallrat kapitalë	14.7	12.3	13.2	35.8
Mallrat e ndërmjetëm	48.9	50.5	51.9	29.7
Mallrat e konsumit	36.4	37.3	34.6	17.4

Një paraqitje më të detajuar të statistikave të importit tregtar sipas klasifikimit BEC do ta gjeni në aneksin statistikor (Tabela – BEC).

Grafik 5. Kontributi në ndryshimin e totalit të importeve.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

• TREGTIA NGA INDUSTRIJA E PËRPUNIMIT AKTIV

Industria përpunuese në vend vazhdon të përbëjë pjesën dërrmuese të transaksioneve tregtare të vendit tonë, me një vëllim të përgjithshëm prej 1,041 milionë eurosh. Tregtia nga industria e përpunimit aktiv rriti nivelin e përfaqësimit të saj krahasuar me vitin paraardhës, duke kontribuar me 32 për qind në transaksionet tregtare të kryera gjatë vitit 2007. Importet për lëndë të parë përfaqësuan 13 për qind të totalit, ndërkohë që 67 për qind e të ardhurave nga eksporti ishin rezultat i rieksperteve. Suficiti, që shoqëron këtë industri prej vitesh, në vlerë absolute u vlerësua 120 milionë euro.

Tregjet dominuese në aktivitetin e kësaj industrie mbeten partnerët fqinjë, Itali dhe Greqi, të cilët prej vitesh janë pozicionuar bindshëm në tregun shqiptar.



• TREGTIA SIPAS PARTNERËVE TREGTARË

Fillimi i vitit 2007 e gjeti vendin në një shkallë të lartë liberalizimi tregtar si me vendet e rajonit ashtu edhe me ato të Bashkimit Evropian. Reduktimi i tarifave doganore, që filloi të aplikohet që në dhjetor të vitit 2006⁸, ishte një hap i rëndësishëm i cili i dha *bum* shkëmbimeve tregtare me pjesën tjetër të botës.

BE mbetet dominues në eksportet tregtare të vendit tonë me botën, duke përfaqësuar rreth 82 për qind të totalit të tyre. Në një renditje sipas partnerëve kryesorë, prej vitesh Italia dhe Greqia përbëjnë pjesën dërrmuese të marrëdhënieve tregtare, duke përfaqësuar këtë vit 1/2 e totalit të tyre. Megjithatë, nga viti në vit vihet re një zhvendosje e

tregtisë nga vendet e BE-së drejt atyre të Ballkanit, kryesuar me Kosovën. Kjo priret për një diversifikim më të lartë në shpërndarjen gjeografike të tregtisë së vendit tonë.

Tabelë 5. Shpërndarja e eksporteve sipas partnerëve tregtarë në vite.

Eksporti sipas partnerëve tregtarë	2005	2006	2007	Ndryshimi 2007/2006 (%)
	Pesha në totalin e eksportit			
Vendet e BE-së - 15, nga të cilat:	88.0	87.8	81.8	16.1
Gjermani	3.3	3.2	2.4	(3.6)
Greqi	10.5	9.6	8.3	7.2
Itali	72.4	72.6	68.0	16.8
Vendet e BE-së - anëtarë të rinj, nga të cilat:	1.4	0.8	1.3	90.6
Bullgari	0.6	0.4	0.7	105.8
Çeki	0.1	0.1	0.0	(46.2)
Rumani	0.2	0.1	0.3	355.2
Vende të tjera evropiane, nga të cilat:	0.1	0.1	0.3	200.5
Rusi	0.1	0.1	0.3	485.1
Ukrainë	0.0	0.0	0.0	115.6
Vendet e Ballkanit	8.5	8.8	12.1	70.9
Bosnje Hercegovinë	0.2	0.5	0.4	(8.3)

Kosovë	4.1	3.8	4.8	58.7
Kroaci	0.0	0.3	0.1	(59.0)
Maqedoni	1.6	1.6	2.4	83.7
Serbi-Mal i Zi	0.8	1.4	2.2	106.2
Turqi	1.7	1.3	2.2	116.3
Amerikë	1.1	0.5	0.7	63.3
Azi, nga të cilat:	0.5	1.6	2.6	98.0
Kinë	0.5	1.1	2.6	180.4
Të tjera	0.3	0.4	1.3	370.0
Totali	100.0	100.0	100.0	24.7

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Njësimi i marrëdhënieve tregtare me vendet e rajonit⁹ pati ndikim të menjëhershëm në tregti, duke bërë që këto vende të shfaqin ritmet më të larta rritëse ndër partnerët tregtarë të vendit tonë. Kjo u ndje më shumë në kahun e eksporteve, të cilat u vlerësuan 71 për qind më të larta se viti paraardhës. Tregu kosovar duket se thith pjesën më të madhe të eksporteve tona me Ballkanin, duke qenë dhe i vetmi vend me të cilin ne kemi suficit tregtar.

Importi sipas partnerëve tregtarë	2005	2006	2007	Ndryshimi 2007/2006 (%)
	Pesha në totalin e importit			
Vendet e BE-së - 15, nga të cilat:	60.4	57.5	54.1	18.9
Gjermani	5.4	5.6	5.5	22.5
Greqi	16.6	15.8	14.6	16.7
Itali	29.3	28.1	27.2	22.0
Vendet e BE-së - anëtarë të rinj, nga të cilat:	6.9	8.1	5.7	(11.0)
Bullgari	2.8	2.7	1.8	(18.1)
Çeki	1.0	1.1	0.8	(8.1)
Rumani	0.7	1.7	0.4	(68.8)
Vende të tjera evropiane, nga të cilat:	8.0	9.1	11.6	61.3
Rusi	4.1	4.1	4.1	25.9
Ukrainë	2.9	3.9	2.6	(14.5)
Vendet e Ballkanit	11.0	12.3	13.2	35.8
Bosnje Hercegovine	0.1	0.3	0.3	40.3
Kosovë	0.4	0.5	0.6	53.2
Kroaci	1.2	1.4	0.9	(20.1)
Maqedoni	1.2	1.6	1.9	52.0
Serbi-Mal i Zi	0.6	0.9	2.2	207.2
Turqi	7.5	7.6	7.3	21.3
Amerikë	2.1	2.0	2.5	60.8
Azi, nga të cilat:	7.5	6.7	7.6	44.2
Kinë	6.7	6.0	6.7	40.5
Të tjera	4.2	4.5	5.3	47.7
Totali	100.0	100.0	100.0	26.2


Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 6. Shpërndarja e importeve sipas partnerëve tregtarë në vite.

1.2.2 SHËRBIMET


Tregtia në shërbime me një rritje mesatare vjetore prej 17 për qind përgjatë harkut kohor 2000-2007, vlerësohet me ritme më të larta rritëse se tregtia e mallrave (15 për qind). Në totalin e përgjithshëm tregtar (mallra dhe shërbime), shërbimet kanë siguruar mëse 64 për qind të të ardhurave në valutë të vendit dhe rreth 31 për qind të shpenzimeve.

Grafik 7. Bilanci i shërbimeve-fluksi neto në milionë euro.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8. Rritja vjetore në importe dhe eksporte shërbimesh.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për vitin 2007, shkëmbimet tregtare në shërbime vlerësohen në rreth 2.8 miliardë euro. Ky vëllim vlerësohet të jetë rritur me 4 pikë përqindje ndaj një viti më parë, duke arritur në 36 për qind ndaj PBB-së.

Rritja më e shpejtë e eksportit (22 për qind) kundrejt importit të kësaj kategorie (18 për qind) ka përmirësuar dukshëm pozicionin neto të tregtisë në shërbime (grafik.6). Kështu pas 5 vitesh deficit në tregtinë e shërbimeve, viti 2007 regjistroi një bilanc pozitiv prej 13 milionë eurosh (grafik 5.).

Zhvillimet e tregtisë në shërbime karakterizohen nga një rritje e vëllimit në shërbimet financiare e të komunikacionit, zgjerim i teknologjisë në shërbimet e informacionit, shumëllojshmërisë së shërbimeve kulturore duke shfaqur potenciale konkurrese të vendit tonë, në tregtinë ndërkombëtare të shërbimeve. Megjithatë, shërbimet e udhëtimit mbajnë peshën kryesore si në shërbimet e ofruara jorezidentëve dhe në ato të përfituara prej tyre (tabelë 7).

Tabelë 7. Struktura e importit dhe eksportit të shërbimeve.

	Pesha në eksporte (%)		Pesha në importe (%)	
	2006	2007	2006	2007
Total	100.0	100.0	100.0	100.0
1.Shërbime transporti	7.9	8.1	10.5	12.7
2.Shërbime sigurimi	0.3	0.4	2.4	3.4
3.Shërbime udhëtimi	69.6	70.8	64.6	65.8
4.Shërbime të tjera	22.3	20.7	22.4	18.1
i. Shërbime komunikacioni	3.6	3.5	0.5	0.3
ii.Shërbime konstruksioni	0.2	0.4	0.1	1.4
iii.Shërbime kompjuteri dhe informacioni	0.1	0.1	0.2	0.8
iv.Asistencë teknike	0.0	0.0	1.3	0.9
v. Shërbime qeveritare	1.6	1.1	0.9	0.8
vi.Shërbime financiare	1.7	2.2	1.4	1.3
vii.Shërbime personale, kulturore e biznesi	1.8	4.3	6.0	3.8
viii.Shërbime të tjera	13.3	9.1	12.1	8.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

- SHËRBIME UDHËTIMI.

Shërbimet e udhëtimit në Shqipëri, tashmë i përgjigjen kërkesës së vazhdueshme në rritje për to, duke kryesuar eksportin dhe importin e shërbimeve, respektivisht me 71 dhe 66 për qind. Të ardhurat neto më të larta se një vit më parë kanë mundur të financojnë deri në masën 4 për qind deficitin tregtar, për vitin 2007.

Në harkun kohor të një viti, të ardhurat në kategorinë “udhëtime” vlerësohen të jenë rritur në rreth 24 për qind. Kjo rritje i atribuohet rritjes vjetore me 62 për qind të numrit të udhëtarëve jorezidentë me shtetësi shqiptare (emigrantë) dhe atë të huaj, që kanë hyrë në Shqipëri.

Fluksi më i lartë i udhëtarëve jorezidentë ka ardhur nga vende të Bashkimit Evropian (76 për qind) dhe të rajonit (15 për qind), duke pasur parasysh që më shumë se gjysma e tyre janë emigrantë. Vihet re një rritje e dukshme e këtyre të ardhurave në periudhat e verës dhe ato të fundvitit, ku udhëtarët emigrantë vizitojnë familjet e tyre.


Rritja e të ardhurave nga shërbimet e udhëtimit, në pjesën më të madhe, ka reflektuar rritjen e çmimeve të shërbimeve, si pasojë e krizës energjiti në Shqipëri, pothuaj gjatë gjithë vitit. Mungesën e energjisë elektrike, ekonomia shqiptare u detyrua ta përballojë me rritjen e kostos së shërbimeve të ofruara jorezidentëve. Rrjedhimisht, rritja e çmimeve shkaktoi rritjen e shpenzimeve ditore, duke reduktuar dhe periudhën e qëndrimit të jorezidentëve në Shqipëri.

Prurjet nga eksporti në turizëm arritën nivelin 1 miliard euro, duke u vlerësuar 27 herë më të larta se ato nga eksporti i mallrave (grafik 7.). Duke ditur që emigrantët konsiderohen udhëtarë jorezidentë, të përhershëm drejt Shqipërisë, fluksi i valutës, që ata shpenzojnë gjatë qëndrimit në Shqipëri, do të vazhdojë të mbetet në nivele të qëndrueshme.

Ndërkohë, importi i shërbimeve të udhëtimit vlerësohet në 923 milionë euro. Këto shpenzime vlerësohen rreth 20 për qind më të larta se një vit më parë. Rritja ka ardhur kryesisht nga fluksi rreth 48 për qind më i lartë i numrit të udhëtarëve rezidentë drejt vendeve të Bashkimit Evropian dhe atyre të rajonit.


Në kuadrin e një cikli ekonomik, këto shpenzime janë financuar indirekt nga 97 për qind e valutës

Grafik 9. Ecuria e eksportit të mallrave dhe e rritjes relative të eksportit udhëtime/mallra.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 10. Shpenzimet për turizëm ndaj fluksit hyrës të remitancave.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

që kanë sjellë emigrantët. Në këtë pikëpamje, “udhëtimet” vlerësohen si një burim mbështetës për llogarinë korente.

Megjithëse cilësia e shërbimit turistik në vend dhe veçanërisht infrastruktura nuk është në standardet e vendeve të rajonit (Greqia, Mali i Zi, Kroacia), sektori i turizmit në vendin tonë ka kontribuar pozitivisht në rritjen ekonomike.

• *SHËRBIME TRANSPORTI DHE SIGURIMI*¹⁰ (SHIH HAPËSIRËN INFORMUESE 3).

Shqipëria vazhdon të jetë importuese neto e shërbimeve të transportit dhe të sigurimit, fenomen ky që vjen si pasojë e rritjes së importeve të mallrave.

Kështu, gjatë vitit 2007 shërbimet e transportit regjistruan një deficit prej 63 milionë eurosh, më të lartë se një vit më parë, si rezultat i rritjes vjetore më të madhe në importe (42 për qind) se sa në eksporte (26 për qind). Megjithatë, liberalizimi në fushën e transporteve si edhe përmirësimi i infrastrukturës, veçanërisht asaj rrugore do të çojnë në reduktimin e kostos dhe marrjen përsipër të transportit nga kompanitë vendase.

Rrjedhimisht, këto zhvillime në të ardhmen e afërt do të ndikojnë drejtpërsëdrejti në uljen e deficitit të shërbimeve të transportit.

Hapësirë informuese 3. Efekti i aplikimit të koeficientëve të vlerësuar në bazë të vrojtimit të tregtisë së jashtme për transportin dhe sigurimin e mallrave, në bilancin e pagesave.

Kostoja e transportit përbën një pjesë të rëndësishme të kostos së transaksionit tregtar, dhe ndryshe nga përbërësit e tjerë të kësaj kostoje, është më e matshme dhe reflektohet drejtpërsëdrejti në çmimin përfundimtar të mallit. Kostoja e transportit luan rol edhe në krijimin ose në dëmtimin e përparësisë krahasuese të një vendi.

Meqënëse informacioni i siguruar për importet nga deklaratat doganore është në C.I.F¹¹, për qëllime të regjistrimit të importeve në vlerën F.O.B¹² sipas standardeve të bilancit të pagesave, këtë vit është kryer sërish vrojtimi i tregtisë së jashtme për të vlerësuar koeficientët e kostos së transportit dhe të sigurimit si dhe elemente të tjera të tregtisë.

Nga vrojtimi rezultoi se:

- Kostoja e transportit të mallrave në importe është 6 për qind e kostos së përgjithshme të transaksionit (nga 12 për qind që është aplikuar deri në vitin 2005) dhe ajo e sigurimit rreth 1 për qind.

Kështu, regjistrimi i importeve në bilancin e pagesave F.O.B u rivlerësua si më poshtë:

Për importet:

- në rreth 83 për qind të tyre, kostot e transportit paguhen nga vetë importuesit, nga të cilat 60 për qind sigurohen nga kompani transporti jorezidente;

- në rreth 17 për qind të tyre, kostot e transportit paguhen nga eksportuesi (jorezident), nga të cilat 35 për qind sigurohen nga kompani rezidente.

Për eksportet:

- në rreth 70 për qind të tyre, kostot e transportit paguhen nga importuesit (jorezidentë), nga të cilat 65 përqind sigurohen nga kompani transporti rezidente;

- në rreth 30 për qind të tyre, kostot e transportit paguhen nga vetë eksportuesi, nga të cilat 65 për qind sigurohen nga kompanitë e transportit jorezidente.

Nga përpunimi i këtyre të dhënave u vlerësuan koeficientët e transportit që ishin subjekt i bilancit të pagesave (transaksionet rezident-jorezident) si më poshtë:

Kredi	Debi
Kosto e transportit 3.5 Eksport +0.6%C.I.F	4.6%C.I.F +0.3 Eksport

Aplikimi i koeficientëve të nxjerrë nga vrojtimi (si kosto për transportin dhe sigurimin e mallrave) ka dhënë një efekt të pozitiv në llogarinë korente të bilancit të pagesave.

Koeficientët e rinj të këtij vrojtimi u aplikuan për vitin 2007 si dhe u bë revizionimi i vitit 2006.

- SHËRBIME TË TJERA.


Shërbimet e tjera kanë rezultuar me të ardhura neto prej 40 milionë eurosh, duke njohur përshpejtim, veçanërisht në krahun e eksporteve. Zhvillime të tjera janë vërejtur në shërbimet e teknologjisë dhe informacionit, shërbimet kulturore, shërbimet qeveritare dhe ato financiare.

1.2.3 TË ARDHURAT

Bilanci pozitiv i të ardhurave faktoriale në fund të vitit (216.8 milionë euro), vlerësohet lehtësisht i rritur kundrejt vitit paraardhës (4 për qind). Rënia e të ardhurave nga puna e punëtorëve sezonalë dhe atyre kufitarë (me 18 për qind) është kompensuar nga rritja prej 25 për qind e të ardhurave neto nga investimet e huaja direkte apo ato të portofolit, si dhe e investimeve të tjera në formën e interesave apo dividendëve të akumuluar nga investimet e portofolit dhe rezervave valutore të sistemit bankar, në institucionet financiare jorezidente.

Të ardhurat hyrëse këtë vit u vlerësuan 278.6 milionë euro ose rreth 6 për qind më të larta se një vit më parë. Rreth 57 për qind e këtij fluksi përfaqësohet nga të ardhurat e investimeve tona jashtë. Kryesisht këto, në formën e interesave të investimeve të sistemit bankar në investime të portofolit (me një rritje vjetore prej 36 për qind) dhe në investime në formën e depozitave. Vlen të përmenden këtu edhe të ardhurat në formën e dividendëve nga investimet tona direkte në ekonomitë e huaja, kryesisht të sektorit financiar.

Grafik 11. Bilanci i të ardhurave (në milionë euro).




Ndërkohë, të ardhurat dalëse regjistrojnë rreth 61.8 milionë euro. Këto përfaqësohen nga shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e interesave të maturuar si dhe nga interesa apo dividendë, të përftuar nga njësitë jorezidente prej investimeve të huaja në ekonominë shqiptare. Këto, në formën e rezervave valutore në sistemin tonë bankar apo të investimeve direkte.

Shqipëria gjatë vitit 2007, ka paguar 26.5 milionë euro për të shlyer interesat mbi huamarrjen, të cilat vlerësohen në rritje kundrejt vitit 2006 (10 për qind).

1.2.4 TRANSFERTAT KORENTE

Të ardhurat nga emigrantët me një rëndësi jetësore për pjesën më të madhe të shqiptarëve, janë bërë një nga fenomenet tipike, më të përfolura në ekonominë shqiptare. Vitet e fundit, këto para nuk konsiderohen vetëm si burime të ardhurash për qëllime joproduktive, për përmbushjen e nevojave themelore aktuale që lidhen me përmirësimin e kushteve të jetesës, por kanë qenë burime financimi edhe për qëllime produktive, në formën e investimeve afatshkurtra dhe afatgjata.

Grafik 12. Ecuria e dërgesave të emigrantëve (në milionë euro).



Këtë vit dërgesat e emigrantëve drejt familjeve të tyre vlerësohen 951.7 milionë euro, me një rritje vjetore të lehtë prej 1.5 për qind. Kjo normë rritjeje vlerësohet si më e ulta në këta dhjetë vitet e fundit (norma mesatare e rritjes ka qenë 11.7 për qind) dhe shpjegohet me faktin e zhvendosjes së flukseve valutore drejt investimeve. Këto të fundit, në formën e pasurive të patundshme apo vendosjen e depozitave në sistemin bankar.

Kontributi i këtyre dërgesave në zbutjen e deficitit tregtar llogaritet në rreth 45.2 për qind, me një rënie 11 pikë përqindje kundrejt vitit të kaluar.

Prurjet nga emigrantët janë shoqëruar edhe nga transfertat zyrtare, kryesisht në formën e asistencës teknike (60 milionë euro), të cilat vlerësohen me një rritje prej 18 milionë kundrejt një viti më parë.

1.3 LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Viti 2007, karakterizohet nga një lëvizje shumë e madhe e kapitalit në të dyja kahet, si në flukset hyrëse ashtu edhe ato dalëse. Përjashtuar transfertat

e njëanshme të kapitalit, llogaria financiare këtë vit përkufizohet në rritje të madhe si të detyrimeve financiare të Shqipërisë me botën, ashtu edhe të mjeteve tona jashtë ekonomisë shqiptare.

Megjithatë, viti u mbyll me një bilanc pozitiv të llogarisë kapitale dhe financiare (rreth 830 milionë euro), duke mundur financimin e deficitit korent me 98 për qind.

Transferrat kapitale, të cilat karakterizohen kryesisht nga grante me karakter investimi si në sektorin shtetëror ashtu edhe atë privat, vlerësohen 37 për qind më të ulta se ato të vitit të kaluar.

Në llogarinë financiare vihet re një rritje sinjifikative e detyrimeve tona valutore përfaqësuar nga investime të huaja direkte, huamarrje afatgjatë me terma të zbutur si dhe investime të tjera afatshkurtra në formën depozitave të vendosura në sistemin tonë bankar, nga institucione financiare jorezidente.

Këtë vit ekonomia shqiptare ka rritur detyrimet e saj financiare me rreth 740 milionë euro. Rritja, e cila vlerësohet rreth 78 qind më lart se viti 2006, vjen kryesisht nga investimet direkte; ato nëpërmjet huamarrjes afatgjatë me terma të zbutur si dhe detyrimeve të krijuara nga depozita të vendosura në sistemin tonë bankar, nga jorezidentët.

1.3.1 NATYRA DHE PËRBËRJA E FLUKSEVE SHQIPTARE TË KAPITALIT

Flukset në llogarinë financiare ndahen midis të treja kategorive kryesore – investime direkte, investime portofoli dhe investime të tjera.


- *INVESTIMET DIREKTE*

Fluksi i investimeve të huaja direkte vazhdon të jetë një faktor dominues në rritjen e detyrimeve financiare dhe në zhvillimet e transaksioneve kapitale e financiare të vendit. Viti 2007, regjistroi 477 milionë euro me një rritje prej 84 për qind kundrejt vitit të kaluar.

Rritja e këtyre investimeve ka ardhur si pasojë e privatizimit dhe e rritjes së kapitalit të huaj në sektorin financiar, kryesisht në atë bankar.

Investimet në fushën e komunikacionit përfaqësojnë 29 për qind të këtyre flukseve hyrëse, të pasuara me të njëjtën peshë nga investimet në sektorin financiar. Marrëveshjet e tregtisë së lirë me BE-në, filluan të ndjehen në rritjen e investimeve në sektorin e industrisë përpunuese, duke sjellë përmirësimin e prodhimit nëpërmjet transferimit të teknologjisë dhe rritjen e kapacitetit teknologjik të prodhimit, në përputhje

Grafik 13. Llogaria financiare në vite
fluksi neto në milionë euro.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

me standardet ndërkombëtare. Kjo, gjë ka çuar në zgjerimin e shkëmbimeve tregtare me këto vende.

Zhvillimet e vullshme në sektorin e ndërtimit, kanë tërhequr vëmendjen e investitorëve të huaj. Prania e kapitalit të huaj në këtë sektor është rritur ndjeshëm përgjatë viteve të fundit, duke sjellë me vete flukse të reja të tij në fusha të reja mbështetëse, të këtij sektori. Njëkohësisht, duhet përmendur investimi i emigrantëve në këtë sektor.

Origjina e investimeve të huaja kryesohet nga vendet e Bashkimit Evropian (79 për qind). Italia dhe Greqia, partnerët tanë kryesorë tregtarë, vazhdojnë të dominojnë investimet në fushën e industrisë përpunuese të tekstileve (veshjeve dhe të këpucëve).

Grafik 14. Financimi i deficitit korent nëpërmjet investimeve të huaja direkte.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

• INVESTIMET E PORTOFOLIT

Investimet e portofolit në bilancin shqiptar të pagesave, janë prezantuar në formën e mjeteve tona financiare, kryesisht të sistemit tonë bankar në bono thesari, të emetuara nga qeveri të huaja. Në fund të vitit 2007, stoku i investimeve të portofolit të ekonomisë shqiptare jashtë u vlerësua 61 milionë euro, me një fluks në rënie prej 18.5 milionë eurosh.

Sistemi bankar këtë vit ka preferuar zhvendosjen e mjeteve nga investime portofoli në depozita me jashtë. Në përbërjen strukturore sipas monedhave, investimet e portofolit gjatë këtij viti mbizotërohen nga ato në dollarë rreth 66 për qind, në euro 23 për qind dhe në stërlinën angleze 10 për qind.

• INVESTIME TË TJERA

Detyrimet financiare, në formën e rritjes së depozitave të jorezidentëve dhe detyrimeve të tjera, të krijuara nga sektorët financiarë dhe ata jofinanciarë, regjistrojnë 227 milionë euro. Këto detyrime janë kryesisht në euro (66 për qind) dhe në dollarë (34 për qind). Këtu vlen të përmendet që kjo rritje ka ardhur edhe si rrjedhojë e vendosjes së depozitave të emigrantëve në sistemin tonë bankar, gjë që tregon rritje të interesit të emigrantëve për të investuar në ekonominë shqiptare.

Detyrimet e ekonomisë shqiptare në formën e kredisë tregtare u rritën me rreth 13.5 milionë euro, e reflektuar kjo edhe në rritje të importeve për këtë periudhë. Kjo rritje vlerësohet në nivele të njëjta me një vit më parë.

Flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte janë shoqëruar me flukse të kapitalit në formën e huamarrjes, duke rritur kështu stokun e detyrimeve të Shqipërisë. Lëvrimet e kredive afatgjata dhe atyre të buta nga jashtë, të

cilat mbeten një faktor i rëndësishëm në rritjen e detyrimeve financiare të Shqipërisë me pjesën tjetër të botës, gjatë këtij viti vlerësohen 129 milionë euro, nga të cilat 93 për qind kanë shkuar në sektorin publik. Kjo rritje ka financuar kryesisht investimet në infrastrukturë, e reflektuar kjo edhe në rritje të importeve për mallra kapitalë, makineri e pajisje, materiale ndërtimi dhe transporti etj.. Rritja e këtyre detyrimeve, ka çuar në rritjen e pagesave të ardhshme të borxhit të jashtëm.

Njëkohësisht, shërbimi i borxhit të jashtëm për vitin 2007 ka reduktuar detyrimet tona me rreth 54 milionë euro, duke përfaqësuar vetëm 7 për qind të eksporteve tona gjatë vitit 2007. Kjo tregon për një aftësi paguese brenda niveleve të pranuar. Ndërkohë, huamarrja private duket se ka ngadalësuar ritmet e rritjes së saj. Krahasuar me vitin 2006, rritja e detyrimeve të këtij sektori vlerësohet sa 27 për qind e fluksit hyrës të një viti më parë dhe zë vetëm 7 për qind të huamarrjes.

Sipas shpërndarjes sektoriale, peshën kryesore në huamarrjen shqiptare e zë huamarrja qeveritare dhe ajo shtetërore e garantuar, me rreth 93 për qind.

Mjetet tona valutore, të investuara jashtë ekonomisë shqiptare, vlerësohen të rritura me 57.4 milionë euro. Vihen re, kryesisht në investimet afatshkurtra dhe ato afatmesme të rezervave valutore të sistemit bankar, në institucionet financiare jorezidente. Akumulimi i depozitave të publikut në sistemin bankar, i ka bërë bankat të preferojnë të ulin ritmin e rritjes së kreditimit të ekonomisë, me 4.4 pikë përqindje dhe të investojnë këto mjete jashtë në formën e depozitave, në institucionet financiare jorezidente. Në përbërjen e këtyre të fundit, 57 për qind janë në dollarë, ndërsa pjesa tjetër është në euro (36 për qind) dhe sterlina angleze (7 për qind).


1.4 REZERVAT VALUTORE

Flukset hyrëse të mjeteve valutore në formën e kapitaleve financiare u reflektuan në rritje të rezervave valutore të autoritetit monetar, me rreth 148.6 milionë euro. Stoku i rezervës valutore në fund të vitit 2007 shënoi nivelin 1.5 miliardë euro, duke qenë i mjaftueshëm për të mbuluar rreth 4 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

1.5 POZICIONI I INVESTIMEVE NDËRKOMBËTARE DHE BORXHI I JASHTËM

Pozicioni ndërkombëtar i investimeve në fund të vitit 2007, shënoi 1.2 miliardë euro ose rreth 15.7 për qind të PBB-së. Pozicioni neto debitor i

Grafik 15. Rezerva valutore në muaj importe.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shqipërisë paraqitet, kështu, në fund të vitit 2007 rreth 2.2 herë më i lartë se ai i fundvitit 2006.

Thellimi i pozicionit neto negativ erdhi si pasojë e rritjes më të madhe të detyrimeve sesa rritja modeste e mjeteve dhe kryesisht, si rrjedhim i pozicionit të thellë negativ të investimeve të huaja direkte dhe investimeve të tjera. Në sajë të rritjes së detyrimeve, kryesisht të investimeve të huaja, shkalla e hapjes financiare të ekonomisë në tregun ndërkombëtar financiar vlerësohet rreth 76.4 për qind ose rreth 5.5 pikë përqindjeje më e lartë se në vitin 2006¹³.

Ndikim në thellimin e pozicionit neto negativ pati edhe zhvlerësimi i dollarit amerikan ndaj euros dhe monedhave të tjera, duke qenë se instrumentet valuore në usd përbëjnë rreth 37 për qind të mjeteve me jashtë, kundrejt rreth 7 për qind të detyrimeve me jashtë.

Tabelë 8. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve të Shqipërisë (në fund të periudhës, në milionë euro).

	Pozicioni në fillim të vitit	Transaksion	Ndryshime në kursin e këmbimit	Ndryshime të tjera	Pozicioni në fund të vitit
Mjetet e huaja	2,316.95	177.18	(149.02)	-	2,345.11
Detyrimet e huaja	2,860.25	733.12	(2.84)	(27.91)	3,562.62
Pozicioni neto i investimeve	(543.30)	(555.94)	(146.18)	27.91	(1,217.51)

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Investimet në mjete të huaja u rritën përgjatë vitit 2007 vetëm me rreth 177 milionë euro, por kjo rritje u zbeh edhe më tej nga efekti negativ i kursit të këmbimit me rreth 149 miliardë euro, duke rezultuar në një rritje totale të stokut të mjeteve me jashtë, me vetëm 1.2 për qind.

Struktura monetare e totalit të mjeteve prej 2.3 miliardë eurosh është tërësisht likuide. Mjetet e rezervës valutore përbëjnë rreth 61 për qind të totalit, ndërsa investimet e tjera, kryesisht depozita të bankave tregtare, rreth 34 për qind.

Tabelë 9. Përbërja e mjeteve të huaja, në milionë euro.

Total në fund të vitit	2006	2007	Ndryshimi në %	Struktura në %
Investimi direkt jashtë	18.36	13.06	-28.9%	0.6%
Investimet e portofolit	87.47	61.26	-30.0%	2.6%
Investime të tjera	809.63	800.50	-1.1%	34.1%
-nga të cilat: Monedha dhe depozita	752.15	759.46	1.0%	32.4%
Mjetet e rezervës	1,401.51	1,470.29	4.9%	62.7%
Totali i mjeteve	2,316.95	2,345.11	1.2%	100.0%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Mjetet e huaja në formën e investimeve të portofolit dhe investimit direkt jashtë, përfaqësohen përkatësisht me rreth 3 dhe 0.6 për qind të totalit të mjeteve të huaja, dhe në fund të vitit 2007 paraqiten me rënie.

Investimet e tjera përbëhen pothuajse totalisht nga balancat e bankave tregtare shqiptare në banka të huaja jashtë, kryesisht llogari e depozita, dhe janë në pjesën më të madhe të investuara në dollarë amerikanë. Efekti i

negativ i kursit të këmbimit ishte, përgjatë vitit, më i lartë se rritja e investimit në këto instrumente, çka bëri që në fund të vitit 2007 pozicioni i tyre të paraqitej me një rënie prej 1.1 për qind.

Efekti i mbiçmimit të monedhës vendase u ndje edhe në stokun e mjeteve të rezervës. Këto edhe pse u rritën me rreth 147 milionë euro përgjatë vitit, në fund të vitit 2007 patën një stok të shprehur në euro në shumën 1.47 miliardë, vetëm 4.9 për qind më të lartë se një vit më parë.

Në kontrast, totali i detyrimeve të huaja prej 3.6 miliardë eurosh përfaqëson investime afatgjata në formën e investimeve të huaja direkte, prej 43.6 për qind dhe investimeve të tjera, prej 56.4 për qind. Krahasuar me fundvitin 2006, detyrimet e huaja në fund të vitit 2007 paraqiten rreth 702 milionë euro (ose rreth 25 për qind) më të larta, kryesisht si rrjedhim i rritjes së investimit të huaj direkt në vend.

Total në fund të vitit	2006	2007	Ndryshimi në %	Struktura në %
Investimi direkt në Shqipëri	1,079.93	1,551.90	43.7%	43.6%
Investime të tjera nga të cilat:				
Huatë	1,496.21	1,689.58	12.9%	47.4%
Monedha dhe depozita	95.16	203.91	114.3%	5.7%
Totali i detyrimeve	2,860.25	3,562.62	24.6%	100.0%

Burimi: Banka e Shqipërisë.


Tabelë 10. Përbërja e detyrimeve të huaja, në milionë euro.

• BORXHI I JASHTËM

Borxhi i jashtëm i Shqipërisë vazhdoi të rritet gjatë vitit 2007, ndonëse me ritëm më të ulët sesa në vitin 2006. Totali i borxhit të jashtëm, arriti nivelin 2 miliardë euro, nga 1.8 miliardë që ishte në fund të vitit 2006. Kjo rritje është shkaktuar kryesisht nga rritja e detyrimeve afatshkurtra të bankave tregtare (në formën e huave dhe monedhave e depozitave).

Përsa i përket ndarjes sektoriale të borxhit të jashtëm në fund të vitit 2007, qeveria e përgjithshme është përgjegjëse për pjesën më të madhe të detyrimeve të borxhit, rreth 53 për qind. Stoku i borxhit të jashtëm të qeverisë së përgjithshme në fund të dhjetorit 2007, arriti në rreth 1.06 miliardë euro (rreth 13.7 për qind e PBB-së) dhe përfaqësohej tërësisht nga hua afatgjata. Po të shtojmë këtu edhe borxhin e jashtëm të autoritetit monetar, borxhin e jashtëm të sektorëve të tjerë të garantuar nga qeveria e përgjithshme, si edhe borxhin e brendshëm publik, totali i borxhit publik në fund të vitit 2007 rezultoi në nivelin 55.8 për qind e PBB-së.

Grafik 16. Ecuria e stokut të borxhit të jashtëm bruto (në fund të periudhave, në miliardë euro).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 11. Stoku i borxhit të jashtëm bruto sipas sektorëve (në fund të periudhave, në miliardë euro dhe në përqindje).

	2005	2006	2007	Struktura në %		Rritja në %	
				2006	2007	2006	2007
1. Qeveria e përgjithshme	0.97	1.00	1.06	54.0	52.8	3.1	6.1
2. Autoriteti monetar	0.10	0.10	0.09	5.3	4.6	(5.3)	(6.1)
3. Sistemi bankar	0.13	0.31	0.47	16.9	23.6	146.7	50.8
4. Sektorë të tjerë	0.34	0.37	0.38	19.8	19.0	9.5	4.2
5. Investime direkte: Huatë ndër - kompani	0.04	0.07	-	4.0	0.0	84.0	(100.0)
Borxhi i jashtëm bruto	1.58	1.85	2.01	100.0	100.0	17.5	8.5


Burimi: Banka e Shqipërisë.

Detyrimet e bankave tregtare në fund të vitit 2007, arritën në rreth 47 milionë euro. Rreth 51 për qind më të larta se në fund të vitit 2006 dhe përbëheshin kryesisht nga detyrime të borxhit afatshkurtra. Huatë afatshkurtra, përfaqësojnë ngarkesën kryesore në detyrimet e jashtme të sektorit bankar me rreth 48 për qind, ndjekur nga monedhat dhe depozitat që zënë 43 për qind të të gjitha detyrimeve të këtij sektori.

Detyrimet e borxhit për sektorë të tjerë arritën në rreth 38 milionë euro, në fund të vitit 2007. Ato përbëheshin kryesisht nga hua afatgjata, të marra prej kompanive jofinanciare nga jorezidentët (rreth 76 për qind), ndjekur nga kreditë tregtare, që zënë rreth 20 për qind të detyrimeve të këtij sektori.

Në fund të vitit 2007, detyrimet në euro zinin pjesën më të madhe të borxhit të jashtëm, me rreth 49 për qind; ndjekur nga ato në sdr, me 36 për qind. Detyrimet e borxhit të jashtëm në formën e instrumenteve në dollarë amerikanë kanë zënë një pjesë të vogël (rreth 7 për qind) të totalit të detyrimeve.

Grafik 17. Struktura e borxhit të jashtëm sipas monedhës (në fund të vitit 2007).



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Duke parë përbërjen e borxhit të jashtëm sipas instrumenteve të financimit, vërehet që mbizotërojnë huatë afatgjata me rreth 73 për qind të totalit. Huatë afatshkurtra përbëjnë 11.3 për qind. Ndërkohë, monedhat dhe depozitat zënë 3.5 për qind të totalit të borxhit.

Treguesit relativë të borxhit të jashtëm paraqiten të përmirësuar, në fund të vitit 2007.

Raporti i borxhit të jashtëm kundrejt eksporteve të mallrave dhe shërbimeve të ekonomisë shqiptare gjatë vitit, arriti në 87.8 për qind në fund të vitit 2007. Duke shënuar rënie me 12 pikë përqindjeje nga niveli që kishte ky raport në fund të vitit 2006. Rënia vjen si rezultat i rritjes më të shpejtë të eksporteve të Shqipërisë (me rreth 25 për qind) përkundrejt rritjes së detyrimeve të borxhit të jashtëm gjatë këtij viti (me rreth 8.5 për qind).

Ndërkohë, raporti i borxhit të jashtëm mbi produktin e brendshëm bruto, ka pothuaj të njëjtin nivel si një vit më parë. Kështu, borxhi i jashtëm mbetet brenda kufijve të 25 për qind të PBB-së, për harkun kohor 2005-2007.

Grafik 18. Raportet e borxhit të jashtëm bruto si përqindje ndaj PBB-së dhe eksporteve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2007, mjetet e rezervës në total paraqiten sa rreth 2.7 herë borxhi afatshkurtër, ndërkohë që janë në një nivel të tillë që të mbulojnë rreth 73 përqind të totalit të borxhit të jashtëm bruto.

2. ANEKS

2.1 POLITIKA TREGTARE TË SHQIPËRISË

Që prej vitit 2002, Shqipëria është në procesin e liberalizimit të tregtisë mbi baza preferenciale, fillimisht me vendet e rajonit dhe më vonë me Bashkimin Evropian.

Liberalizimi i regjimit tregtar të vendit tonë duhet parë si proces i një rëndësie të veçantë, pasi krijon mundësi shumë të mëdha zgjerimi për biznesin shqiptar. Gjithashtu, edhe për të qenë më konkurrues në treg. Statistikat në vite tregojnë intensitet në drejtimin e rritjes së importeve dhe eksporteve, të tregtisë së vendit tonë.

Krijimi i një zone të lirë tregtare ndërmjet Shqipërisë me vendet e Ballkanit dhe të BE-së, ka sjellë një efekt pozitiv në rritjen e mirëqenies së vendit. Rezultat ky, i zhvendosjes së burimeve drejt një përdorimi më eficient. Kjo do të thotë që sektorët apo produktet me përparësi konkurruese më të mëdha do të thithin burimet aktuale.

Në kuadër të sistemit shumëpalësh të tregtisë, Shqipëria u pranua si anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë, në shtator të vitit 2000. Politikat tregtare të vendit tashmë janë të ankoruara nga sistemi rregullator i tregtisë globale, gjë që i bën këto politika shumë më transparente dhe të besueshme. Në kuadër të anëtarësimit në OBT, vendi ynë u angazhua për një tarifë maksimale prej 20 për qind, ndërkohë që ka ndërmarrë edhe nisma sektoriale, për liberalizimin gradual të tregtisë.

Në kuadër të integritit evropian, që në vitin 2003, Shqipëria filloi negociatat me Bashkimin Evropian për nënshkrimin e një Marrëveshjeje Stabilizim-Asociimi (MSA). Autoritetet kanë realizuar një raund teknik negociatash, për kapitujt e tregtisë së mallrave industrialë, si dhe një sërë procese negociatash tregtare, për mallrat bujqësorë.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim – Asociimit (MSA) (në Luksenburg, më 12 dhjetor 2006), zhvillimi dhe forcimi i marrëdhënieve tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve të BE- së, u bë akoma dhe më i nevojshëm. Për këtë qëllim, më 1 dhjetor 2006 hyri në fuqi Marrëveshja e Përkohshme, që lejon aplikimin e dispozitave të MSA- së, që lidhen me

tregtinë. Ajo zëvendësoi Marrëveshjen për Bashkëpunim Tregtar dhe Ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe BE –së, brenda një periudhe 10-vjeçare. Sipas kësaj marrëveshjeje, taksat doganore për produktet industriale shqiptare që hyjnë në tregun evropian ulen në zero. I njëjti rregull aplikohet për pjesën më të madhe të produkteve bujqësore, ndërkohë që për produktet e tjera, taksat do të vazhdojnë të ulen gradualisht deri në eliminimin e plotë. Zbatimi i standardeve do të jetë gjithnjë e më shumë një faktor përcaktues për të vendosur, se duhet shpenzuar për të arritur nivelin e standardeve evropiane.

Me inkurajimin e Bashkimit Evropian, vendet e Evropës Juglindore (shtatë prej tyre, respektivisht: Shqipëria, Bosnje-Herzegovina, Maqedonia, Bullgaria, Rumania, Kroacia, Serbia dhe Mali i Zi, duke shtuar më vonë dhe Kosovën në këtë nismë si dhe Moldavinë) kanë nënshkruar që në vitin 2001, një memorandum mirëkuptimi për lehtësimin dhe liberalizimin e tregtisë midis tyre. Kjo do të thotë lëvizje e lirë e mallrave dhe shërbimeve, që shoqërohet me shfrytëzim më të mirë të përparësive krahasuese të vendeve. Objektivi përfundimtar është që, nëpërmjet rrjetit dypalësh të marrëveshjeve të tregtisë së lirë, të krijohet një zonë e tregtisë së lirë mes këtyre vendeve, deri në fillim të vitit 2008.

Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë me Bosnje-Hercegovinën, në dhjetor të vitit 2004, Shqipëria ka plotësuar kuadrin dypalësh të marrëveshjeve të tregtisë së lirë në rajon.

Krijimi i zonës së lirë tregtare mes vendeve të rajonit prek kryesisht sektorin industrial, ndërsa sektorët e bujqësisë dhe të industrisë së mallrave ushqimorë, në shumë raste parashikojnë hapje të pjesshme e graduale ose ruajtje të regjimit aktual tregtar.

Në kuadrin e Memorandumit të Mirëkuptimit për Lehtësimin dhe Liberalizimin e Tregtisë të Paktit të Stabilitetit (nënshkruar nga ministrat e tregtisë të vendeve të Evropës Juglindore në Bruksel, në qershor 2001), Qevera Shqiptare u angazhua për zbatimin e politikave liberale të tregtisë. Një ndër kërkesat e Paktit të Stabilitetit është që Ballkani të shndërrohet në një zonë tregtare të lirë. Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe me të gjitha vendet pjesëmarrëse në memorandum, duke përfshirë dhe Kosovën.

Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e nënshkruar ndërmjet Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë, në 21 dhjetor 2006 është një marrëveshje asimetrike. Në bazë të saj produktet shqiptare që eksportohen në Turqi nuk do t'i nështrohen taksave doganore. Në të njëjtën mënyrë, tarifatat për produktet industriale të veçanta, të importuara nga Turqia do të vazhdojnë të ulen dhe do të eliminohen pas 5 vjetësh.

Aktualisht, Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë me Bullgarinë dhe Rumaninë janë eliminuar që prej momentit që ato u bënë shtete anëtare të BE- së, dhe tani me to do të aplikohet Marrëveshja e Përkohshme. MTL-të me vendet e tjera të rajonit, me përjashtim të Turqisë, janë hequr me hyrjen në fuqi të CEFTA- s, në korrik të 2007-ës.¹⁴

Më 6 prill 2006, u nënshkrua një deklaratë e përbashkët për shtrirjen e CEFTA-s në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, UMNİK për Kosovën, Moldavi, Serbi dhe Mal i Zi, në Samitin e kryeministrave të Evropës Juglindore, të mbajtur në Bukuresht. Anëtarët aktualë të CEFTA- s janë Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Shqipëria. Marrëveshja e zgjeruar u iniciua më 9 nëntor 2006 në Bruksel dhe u nënshkrua më 19 dhjetor 2006. Ratifikimi u realizua në mars 2007 dhe Traktati i ri i CEFTA- s ka hyrë në fuqi, në korrik 2007. CEFTA e zgjeruar do të konsolidojë rrjetin dypalësh të marrëveshjeve të tregtisë së lirë dhe do të sigurojë që Shqipëria të jetë një partner i barabartë brenda CEFTA-s. Ajo do t'u sigurojë eksporteve shqiptare akses pa taksa në një treg të madh. Gjithashtu, do të krijojë dhe institucione të përbashkëta, për të nxitur më tej zhvillimin ekonomik dhe për të trajtuar barrierat e tregtisë në mënyrë bashkëpunuese. Përgatitja e një tregu të hapur midis vendeve të rajonit do ta bëjë të aftë vendin të kërkojnë nesër integrimin në ekonominë evropiane, pjesë e së cilës çdo vend i rajonit aspirojnë të jetë.

2.2 MATJA E SHËRBIMEVE TË UDHËTIMIT, PËR VITIN 2007

2.2.1 HYRJE

Shërbimet e udhëtimit konsiderohen si një industri me përfitime ekonomike të qenësishme për vendet mikpritëse, veçanërisht për vendet në zhvillim. Promovimi i këtyre vendeve si destinacione turistike, ka për motiv kryesor edhe rritjen ekonomike. Shpenzimet gjatë udhëtimit dhe eksport-importi i mallrave dhe shërbimeve të lidhura me të, i sjellin të ardhura ekonomisë pritëse dhe nxisin investimet e nevojshme në sektorë të tjerë të ekonomisë.

Impaktet kryesore të shërbimeve të udhëtimit në një ekonomi, lidhen me të ardhurat në valutë, kontributet në buxhetin e qeverisë, përmirësimin e infrastrukturës, në krijimin e vendeve të punës dhe të mundësive të biznesit. Sipas Organizatës Botërore të Turizmit, turizmi është një ndër pesë kategoritë kryesore të eksportit, në jo më pak se 83 për qind të vendeve dhe është burimi kryesor i të ardhurave në valutë për, më shumë se 38 për qind të vendeve.

Shërbimet e udhëtimit krijojnë vende pune drejtpërdrejt nëpërmjet hoteleve, restoranteve, klubeve, taksive dhe shitjeve të suvenireve, dhe jo drejtpërdrejt nëpërmjet ofertës së mallrave dhe shërbimeve të duhura. Në turizëm mbështetet rreth 7 për qind e fuqisë punëtore në botë.

Turizmi nxit edhe qeveritë vendore të përmirësojnë infrastrukturën nga biznesi i turizmit, si: sistemet e ujësjellësit, rrugët, energjinë elektrike dhe telekomunikacionin. Nëpërmjet këtyre, përmirësohet edhe cilësia e jetës së rezidentëve dhe lehtësohet turizmi.

Shërbimet e udhëtimit në Shqipëri, tashmë i përgjigjen kërkesës së vazhdueshme në rritje për to dhe kanë potenciale të tërheqin vizitorët edhe nga rajonet e tjera të botës.

Shërbimet e udhëtimit janë një nga përbërësit e rëndësishëm të llogarisë korente, prandaj matja e tyre vlerësohet.

Sektori i Bilancit të Pagesave harton në bazë vlerësimesh, të ardhurat dhe shpenzimet e shërbimeve të udhëtimit. Vlerësimet bëhen në bazë të vrojtimit që janë ndërmarrë, që nga viti 1999, në bashkëpunim me Institutin e Statistikës (INSTAT).

Vrojtimi kryhet nga Banka e Shqipërisë dhe sponsorizohet prej saj. Anketimi kryhet nga INSTAT duke intervistuar në terren, me frekuencë tremujore.

2.2.2 VROJTIMI I SHËRBIMEVE TË UDHËTIMIT

i. KONCEPTET KRYESORE TË PËRDORURA NË ANALIZË¹⁵

- Kategoria “Udhëtime” mbulon kryesisht mallrat dhe shërbimet që përfitojnë udhëtarët, gjatë udhëtimeve më të shkurtra se një vit.
- Një udhëtar është një individ, që qëndron për më pak se një vit për çfarëdolloj qëllimi, në një ekonomi në të cilën ai nuk është rezident. Rregulli i qëndrimit më pak se një vit nuk zbatohet për studentët dhe pacientët, të cilët mbeten rezidentë të vendit të tyre të origjinës. Si të tillë, ata konsiderohen udhëtarë dhe shpenzimet e tyre, përfshihen tek shërbimet e udhëtimit.
- Udhëtar ditor është individ që udhëton në vendin që viziton, por nuk qëndron asnjë natë.
- Shërbimet e udhëtimit të kryer, sipas qëllimit ndahen: për qëllime biznesi dhe për qëllime personale.
- Udhëtarët për qëllime biznesi udhëtojnë jashtë për të gjitha llojet e aktiviteteve të biznesit. Të tilla konsiderohen ekuipazhet e transportit, punonjësit qeveritarë për udhëtime zyrtare, punonjësit e organizatave ndërkombëtare për biznese zyrtare dhe punonjësit e ndërmarrjeve, që nuk janë rezidentë në ekonominë në të cilat punojnë. Qëllimi i udhëtimit të tyre mund të jetë për fushata marketingu, studim tregu, negociata tregtare, misione, takime, punë instaluese ose prodhuese, ose për arsye të tjera biznesi në emër të një ndërmarrjeje rezidente të një ekonomie tjetër.
- Udhëtarët për qëllime personale udhëtojnë jashtë për arsye të tjera, jo biznesi. Të tilla janë pushimet, pjesëmarrjet në aktivitete kulturore dhe argëtimi, vizitat shoqërore apo familjare, për pelegrinazh, për qëllime shëndetësore dhe arsimimi.
- Për efekt analize, shërbimet e udhëtimit ndahen edhe sipas llojit të shpenzimeve:

- për mallra,
 - për akomodim, ushqim dhe pije;
 - për të tjera, gjatë udhëtimit.
- Ndër mallrat dhe shërbimet më të zakonshme, që përfshihen në udhëtime, janë hotelet, banesat me qira, ushqimi, pijet, argëtimi dhe transporti brenda vendit që vizitohet (të gjitha të konsumuara në ekonominë e vizituar) si edhe dhuratat, suvenirët apo artikuj të tjerë të blerë nga udhëtari, por që mund të konsumohen dhe jashtë vendit të vizituar.

ii. QËLLIMI

- Qëllimi parësor i vërtetimit është mbledhja e informacionit për llogaritjen e koeficientëve vlerësues të kohëqëndrimit dhe shpenzimeve të udhëtarëve rezidentë dhe jorezidentë, gjatë udhëtimeve të tyre përkatësisht, jashtë dhe brenda Shqipërisë.
- Qëllimi specifik lidhet me karakteristikat e secilës kategori të intervistuar, me qëllimin e udhëtimit, vendin e origjinës për jorezidentët që vizitojnë Shqipërinë dhe destinacionin e udhëtimit për rezidentët që udhëtojnë jashtë vendit etj..

iii. METODOLOGJIA

- Përcaktimi i zgjedhjes

Vërtetimi kryhet me frekuencë tremujore, me një vëllim zgjedhjeje prej 1000 individësh për tremujor. Përcaktimi i pikave kufitare të intervistimit bazohet mbi të dhënat e marra çdo tremujor nga Ministria e Brendshme. Këto të dhëna përmbajnë numrin e hyrje-daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Jo të gjitha pikat kufitare përfshihen në vërtetim. Vërtetimi përqendrohet në ato pika kufitare, ku dhe lëvizja e individëve është e lartë. Popullata që synohet të mbulohet nëpërmjet këtij vërtetimi përbëhet nga dy kategori: kategoria e udhëtarëve rezidentë, që kthehen nga udhëtimi jashtë vendit dhe kategoria e udhëtarëve jorezidentë, që largohen nga Shqipëria. Udhëtarët rezidentë përfshijnë rezidentët me kombësi shqiptare dhe ata me kombësi të huaj, që kthehen mbas një udhëtim jashtë vendit. Edhe në kategorinë e udhëtarëve jorezidentë aplikohet ndarja e jorezidentëve me kombësi shqiptare (emigrantët shqiptarë) dhe të huaj. Gjithashtu, brenda dy kategorive kryesore veçohen udhëtarët ditorë.

- Instrumenti për mbledhjen e informacionit

Nisur nga kategoritë e përmendura më sipër, Departamenti i Statistikës ka hartuar dy pyetësorë, njëri në shqip dhe tjetri në anglisht. Të dy pyetësorët përbëhen nga shtatë pyetje, katër cilësore dhe tre sasiore.

- A. Identifikimi i udhëtarit.
- B. Shteti i qëndrimit.
- C. Qëllimi i udhëtimit.

- D. Akomodimi në vendin që vizitohet.
- E. Koha e qëndrimit.
- F. Shpenzimet e bëra gjatë udhëtimit.
- G. Dhurata apo shërbime falas, të përfituara gjatë udhëtimit.

- Puna në terren

Për çdo tremujor intervistohen 1000 individë, udhëtarë rezidentë të pyetur në momentin e kthimit nga udhëtimi jashtë dhe ata jorezidentë, në momentin e largimit nga Shqipëria. Anketimi kryhet nga intervistues të rekrutuar nga INSTAT-i, të udhëzuar në kryerjen e vrojtimit nga specialistët e Departamentit të Statistikës.

- Përpunimi i informacionit

Hedhja dhe përpunimi i të dhënave realizohet nga Departamenti i Statistikës. Hedhja e të dhënave kryhet sipas pikave kufitare dhe sipas kategorisë së udhëtarëve. Përpara se të përpunohen të dhënat, shmangen vlerat ekstreme si edhe llogariten në euro shpenzimet mesatare ditore. Mbas përpunimit të të dhënave konkludojmë se sa ditë ka qëndruar mesatarisht një udhëtar për qëllime personale apo biznesi, për secilën pikë kufitare. Gjithashtu për secilën pikë kufitare, llogaritet se sa ka shpenzuar mesatarisht një udhëtar për qëllime personale apo biznesi. Këta koeficientë vlerësues llogariten për të gjashtë tipet e udhëtarëve: rezidentët me kombësi shqiptare dhe ata të huaj; jorezidentët me kombësi shqiptare (emigrantët) dhe ata të huaj; si dhe udhëtarët ditore rezidentë dhe jorezidentë.

- Aplikimi i rezultateve të vrojtimit për vlerësimin e shpenzimeve dhe të ardhurave të shërbimeve të udhëtimit, në bilancin e pagesave

Rezultatet e marra nga kategoria e jorezidentëve përdoren për të vlerësuar të ardhurat nga shërbimet e udhëtimit (kredi), ndërsa ato të siguruara nga kategoria e rezidentëve, përdoren për vlerësimin e shpenzimeve (debi). Në bilancin e pagesave, si të ardhurat ashtu edhe shpenzimet për shërbimet e udhëtimit, ndahen në 'biznes' dhe 'personale'. Për këtë arsye, rezultatet për kohëqëndrimin dhe shpenzimet ditore aplikohen veçanë.

Më poshtë jepet formula që përdoret për vlerësimin e kredisë dhe debisë, për shërbimet e udhëtimit.

Eksport (Shërbime udhëtimi) = nr. JR* mes.(kohëqëndrim)* mes.(shpenz. ditore).


Import (Shërbime udhëtimi) = nr.R* mes.(kohëqëndrim)* mes.(shpenz. ditore).

ku, JR- janë jorezidentët dhe R- janë rezidentët.

iv. ANALIZA E REZULTATEVE


a. Numri i udhëtarëve.

Grafik 19. Fluksi hyrës dhe dalës i jorezidentëve dhe rezidentëve në tremujorë, gjatë viteve 2004-2007.




Burimi: Vlerësime të Bankës së Shqipërisë, bazuar në të dhënat e Ministrisë së Brendshme

Grafik 20. Shpërndarja e jorezidentëve, sipas vendit të origjinës.



Burimi: Vrojtimi i kryer nga Banka e Shqipërisë

Grafik 21. Shpërndarja e rezidentëve sipas destinacionit të udhëtimit.



Burimi: Vrojtimi i kryer nga Banka e Shqipërisë

Viti 2007 është karakterizuar nga një fluks i lartë udhëtarësh si në hyrje dhe në dalje. Numri i rezidentëve që kanë udhëtuar jashtë vendit ka qenë 1.5 herë më i madh në krahasim me një vit më parë. 7 për qind e këtij fluksi janë udhëtarët ditorë.

Fluksi i jorezidentëve që kanë vizituar Shqipërinë ka rezultuar 1.6 herë më i lartë. Një peshë të madhe, prej 51 për qind e zënë emigrantët, ndërsa ekskursionistët vetëm 11 për qind.

Udhëtarët jorezidentë përfaqësohen nga vende të Bashkimit Evropian (76 për qind) dhe të rajonit (15 për qind). Konkretisht, fluksi më i lartë ka ardhur nga Greqia (31 për qind), Italia (29 për qind), Gjermania (5 për qind), duke pasur parasysh që më shumë se gjysma e jorezidentëve janë me kombësi shqiptare, por me banim në këto vende. Për rajonin cilësojmë ardhjet kryesisht nga vende si: Maqedonia (5 për qind), Turqia (3 për qind), Kosova (3 për qind).

Destinacionet kryesore të rezidentëve mbeten vendet e Bashkimit Evropian (75 për qind) dhe ato të rajonit (22 për qind). Kështu, një pjesë e konsiderueshme e rezidentëve kanë udhëtuar drejt Greqisë (41 për qind), Italisë (24 për qind), Malit të Zi (8 për qind), Maqedonisë (5 për qind), Kroacisë (2 për qind), Kosovës (1 për qind).


Shpërndarja e udhëtarëve sipas shteteve, lejon përcaktimin edhe të shportës valutore hyrëse dhe dalëse e përbërë nga euro, paundi britanik dhe dollari amerikan.

Vrojtimi tregon se 22 për qind e jorezidentëve kanë ardhur për qëllime biznesi, ndërsa rreth 78 për qind për qëllime personale.

Ndërkohë, udhëtimet e rezidentëve jashtë vendit kanë qenë kryesisht personale, në 67 për qind të rasteve të vrotuara.

Në të dyja kategoritë e udhëtarëve, mesatarisht 58 për qind akomodohen tek të afërmit ose miqtë, 34 për qind qëndrojnë në hotel dhe 3 për qind në shtëpi me qira. Kjo thekson edhe më tepër faktin se pjesa më e madhe e jorezidentëve që vizitojnë Shqipërinë janë emigrantët shqiptarë. Po kështu, rezidentët që udhëtojnë jashtë, qëndrojnë tek emigrantët.

Grafik 22. Shpërndarja e jorezidentëve dhe rezidentëve, sipas qëllimit të udhëtimit.




Burimi: Vrojtimi i kryer nga Banka e Shqipërisë.

b. Kohëqëndrimi¹⁶.

Nga të dhënat e vërtetimit, ka rezultuar se jorezidentët kanë qëndruar 7 netë për qëllime personale dhe 5 netë për biznes. Në këtë kategori udhëtarësh veçojmë emigrantët, të cilët kanë qëndruar 10 netë për arsye personale. Ndërkohë, kohëqëndrimi i rezidentëve është luhatur në 9 netë për qëllime personale dhe 4 netë për biznes.


Kohëqëndrimi për dy kategoritë e udhëtarëve kushtëzohet edhe nga periudhat sezonale të vitit. Kështu, në tremujorin e tretë vërehet dhe kohëqëndrimi më i lartë, gjatë të cilit haset dhe fluksi më i lartë i udhëtarëve si në hyrje dhe në dalje.

Grafik 23. Shpërndarja e jorezidentëve dhe rezidentëve, sipas akomodimit në vendin e vizituar.



Burimi: Vrojtimi i kryer nga Banka e Shqipërisë.

Grafik 24. Kohëqëndrimi për jorezidentët dhe rezidentët sipas qëllimit të udhëtimit, në tremujorë, për vitet 2004-2007.



Burimi: Vrojtim i kryer nga Banka e Shqipërisë.


c. Shpenzimet mesatare ditore.

Për të dyja kategoritë e udhëtarëve, shpenzimet mesatare për qëllime personale vlerësohen më të ulëta se ato për biznes.

Për kategorinë e jorezidentëve, janë ndarë shpenzimet e kryera nga emigrantët dhe ekskursionistët. Jorezidentët kanë shpenzuar 89 euro në ditë për qëllime personale dhe 118 euro për biznes. Nën këtë kategori udhëtarësh, emigrantët kanë shpenzuar mesatarisht 50 euro në ditë për arsye personale dhe 68 euro për biznes. Piku më i lartë i tyre është shënuar gjatë sezonit turistik.

Ndonëse me përqindje të ulët në fluksin total të jorezidentëve, udhëtarët ditorë karakterizohen nga shpenzime të larta për të dyja qëllimet, përkatësisht 84 euro, për personale dhe 106 euro, për biznes.

Gjatë vitit 2007, rezidentët kanë shpenzuar mesatarisht 115 euro në ditë, për biznes dhe 78 euro, për qëllime personale. Ndërsa, në udhëtimet ditore për qëllime personale, shpenzimet janë vlerësuar 50 euro dhe 60 euro ato për biznes.




Karakteristikë në strukturën e shpenzimeve dhe në peshën që ato zënë në buxhetin e udhëtarëve, mbetet efekti “emigrant dhe udhëtar ditor”. Për t’i bërë të krahasueshme, kemi përjashtuar shpenzimet e kryera nga jorezidentët-emigrantët, jorezidentët-ditorë si dhe rezidentët-ditorë. Duke pasur parasysh që emigrantët shfrytëzojnë mundësinë e akomodimit tek të afërmit, ndërsa udhëtarët ditorë nuk kanë shpenzime akomodimi.

Udhëtarët jorezidentë janë të prirur të shpenzojnë rreth 65 për qind, për akomodim dhe ushqim, ndërsa pjesën tjetër për veprimtari të ndryshme.

Për udhëtarët rezidentë, një peshë të vogël zë akomodimi (11 për qind) dhe ushqimi (24 për qind), ndërsa peshën më të madhe e zënë blerjet e tjera (65 për qind).

Grafik 26. Struktura e shpenzimeve të kryera nga rezidentët dhe jorezidentët¹⁷.



Burimi: Vrojtim i kryer nga Banka e Shqipërisë.

Për udhëtimet me paketë turistike, vetëm 3 për qind e rezidentëve kanë kryer të tilla, kryesisht drejt vendeve si Mal i Zi, Kroaci, Turqi, Itali.

3. ANEKS METODOLOGJIK

Jorezident:

Do të konsiderohet çdo individ, ndërmarrje apo organizatë e vendosur në një vend tjetër jashtë Shqipërisë. Bankat që operojnë në shtete të tjera janë shembuj të jorezidentëve. Personat, të cilët nuk jetojnë zakonisht (për një periudhë kohore më shumë se një vit) në Shqipëri, janë gjithashtu jorezidentë.

Rezident:

Konsiderohen të gjitha ndërmarrjet që operojnë në Shqipëri, pavarësisht nëse ato janë pronë e personave shqiptarë apo të huaj. Personat që zakonisht jetojnë në Shqipëri konsiderohen, gjithashtu, rezidentë, pavarësisht nga shtetësia apo kombësia e tyre. Një përjashtim nga ky rregull janë personelet e huaja, të vendosura në ambasadat e akredituara në Shqipëri. Këto konsiderohen jorezidentë. Në përgjithësi, në rast se është e vështirë të përcaktohet, rezidenca e një subjekti do të gjykohet duke u mbështetur në periudhën që ai operon në Shqipëri. Nëse kjo periudhë është më e gjatë se 1 vit, subjekti do të konsiderohet rezident.

Import i mallrave:

Konsiderohet procesi i kalimit të pronësisë së mallrave të lëvizshëm (me disa përjashtime) nga një jorezident tek një rezident.

Eksport i mallrave:

Konsiderohet procesi i kalimit të pronësisë së mallrave të lëvizshëm (me disa përjashtime) nga një rezident tek një jorezident.

Bilanc tregtar:

Paraqet diferencën ndërmjet eksporteve dhe importeve. Nëse kjo diferencë është pozitive ose negative, atëherë kemi të bëjmë përkatësisht me suficit ose deficit tregtar.

Klasifikimi SITC:

Është një klasifikim statistikor i grupmallrave sipas një kodi njëshifror, i nevojshëm për qëllime të analizave ekonomike dhe në mënyrë që të thjeshtojë krahasimin ndërkombëtar të të dhënave të tregtisë së mallrave. Ai përftohet nga rigrupimi i sistemit të harmonizuar HS prej 97 grupmallrave.

Importe për përpunim aktiv:

Mallra të blerë përkohësisht dhe të destinuar për t'u përdorur si lëndë e parë për përpunim të mëtejshëm.

Rieksperte:

Mallra të hyrë fillimisht në vend dhe të destinuar vetëm për eksport, mbas përpunimit ose shndërrimit në ekonominë vendase.

Marrëveshje e tregtisë së lirë:

Është një dokument i negociuar dhe i rënë dakord mes palëve, me objektiv lëvizjen e mallrave dhe të shërbimeve ndërmjet vendeve partnere, dhe që eliminon ose ul ndjeshëm tarifat dhe barrierat tregtare.

Shkalla e hapjes tregtare:

Mat raportin e vëllimit tregtar kundrejt PPB-së të një vendi dhe shpreh se sa e hapur është ekonomia e një vendi kundrejt pjesës tjetër të botës. Sa më i madh ky raport aq më i hapur ekonomikisht është një vend.

Rregullat e origjinës:

Rregullat e origjinës janë kriteri i përdorur për të përcaktuar "nacionalitetin" e një produkti. Rregulli i gjithëpranuar për dhënien e origjinës është se shteti ku është kryer transformimi i fundit thelbësor ose procesi i mjaftueshëm, është shteti i origjinës së produktit.

BEC (Broad Economic Categories):

Klasifikimi i statistikave të tregtisë së jashtme sipas kategorive ekonomike BEC, ofron për përdoruesit dhe analizuesit e këtyre statistikave, kategorizimin e tregtisë sipas qëllimit përfundimtar të përdorimit.

Mallra të ndërmjetëm:

Mallra të blerë për rishitje ose për përpunim të mëtejshëm, me qëllim prodhimin e produkteve përfundimtare për konsumatorin. Në procesin e prodhimit, mallrat e ndërmjetëm ose bëhen pjesë e produktit përfundimtar ose transformohen totalisht gjatë procesit.

Mallra kapitalë:

Mallrat që shërbejnë për prodhimin e mallrave dhe shërbimeve përfundimtare, dhe që nuk janë pjesë e tyre si për shembull, makineritë, mjetet e transportit, pajisjet e zyrës etj..

Mallra konsumi:

Mallra të blerë për përdorim vetjak ose personal.

Shërbime udhëtimi:

Përbërës të bilancit të pagesave, në të cilin regjistrohen transaksionet në mallra dhe shërbime, të lidhura me shpenzimet e udhëtarëve. Sipas manualit të FMN-së, këto transaksione regjistrohen në debinë dhe kredinë e zërit "udhëtime".

Udhëtarë:

Sipas bilancit të pagesave, janë individët që qëndrojnë jashtë vendit për më pak se një vit për çdo qëllim tjetër përveçse: (a) për të punuar në një bazë ushtarake, ambasadë e të tjera agjenci qeveritare; ose (b) për të shoqëruar ose për të qenë nën varësinë direkte të individëve të kategorisë (a); apo (c) për t'u angazhuar direkt në aktivitet prodhues për një njësi rezidente të ekonomisë në fjalë.

Shpenzimet e udhëtarëve:

Shpenzimet totale në mallra dhe shërbime, të bëra nga një udhëtar ose për llogari të një udhëtari, për dhe gjatë udhëtimit dhe qëndrimit në destinacion.

Udhëtim personal:

Shpenzime të bëra nga individë që shkojnë jashtë, për qëllime të ndryshme nga biznesi. Këtu përfshihen pushimet dhe aktivitetet të tjera argëtuese dhe kulturore, vizita tek miqtë dhe të afërmit, udhëtime për qëllime pelegrinazhi dhe arsye të tjera fetare, edukim, trajtim shëndetësor etj..

Udhëtim biznesi:

Përfshin shpenzime të bëra nga: a) individë që shkojnë në një vend të ndryshëm nga ai ku punojnë zakonisht, me qëllim që të ndërmarrin çfarëdo lloj aktiviteti profesional: shitje, takime pune etj.; b) punëtorë sezonalë dhe kufitarë.

Investime të huaja direkte:

Investimet direkte përcaktohen si një kategori e investimeve ndërkombëtare në të cilën një njësi rezidente në një ekonomi (investitori direkt) ndërmerr një interes të qëndrueshëm në një kompani rezidente të një ekonomie tjetër. Investimi direkt nënkupton një marrëdhënie afatgjatë mes investitorit direkt dhe kompanisë së investimit direkt, dhe një shkallë të konsiderueshme influence të investitorit në kompani (Manuali i Bilancit të Pagesave botimi i 5^{të} i FMN-së, rekomandon një minimum pjesëmarrjeje në kapital prej 10 për qind).

Investime portofoli:

Përfaqësojnë investime në pasuri dhe letra me vlerë të borxhit, me natyrë të ndryshme nga ato të investimit direkt. Duke iu referuar Manualit të Bilancit të Pagesave botimi i 5^{të} i FMN-së, rekomandohet që shkalla e influencës së investitorit në kompani, të jetë më e vogël se 10 për qind.

Investime të tjera:

Llogaria "investime të tjera" përfshin të gjitha transaksionet financiare, të cilat nuk konsiderohen investime direkte, investime portofoli apo mjete të rezervës. Në bilancin shqiptar të pagesave, kjo kategori përfshin kryesisht huamarrjen, monedha dhe depozita, kredinë tregtare si dhe detyrime e mjete të tjera.

Rezerva:

Përfaqëson mjete lehtësisht të disponueshme dhe të kontrolluara nga autoritetet monetare dhe që përdoren për financimin direkt të mosbalancimit

të pagesave, për rregullimin indirekt të madhësisë së këtyre mosbalancimeve nëpërmjet ndërhyrjes në tregjet e këmbimit, duke ndikuar në kurset e këmbimeve valutore dhe/ose për qëllime të tjera.

Pozicioni ndërkombëtar i investimeve:

Pozicioni ndërkombëtar i investimeve është gjendja e bilancit të pretendimeve dhe detyrimeve të huaja financiare, në një moment të caktuar kohe.

Klasifikimi kryesor i pasqyrës së PNI-së është ai mes mjeteve dhe detyrimeve. Diferenca ndërmjet tyre paraqet pozicionin neto të investimeve.

Klasifikimi i mëtejshëm bëhet sipas funksionit: kategoritë funksionale të mjeteve dhe detyrimeve janë (i) investimet direkte, (ii) investimet e portofolit, (iii) derivativët financiarë; dhe (iv) investime të tjera. Në mjetet e huaja përfshihen edhe mjetet e rezervës, të mbajtura nga autoriteti monetar.

Niveli i tretë i klasifikimit të PNI-së është ndarja sektoriale e mjeteve dhe detyrimeve financiare: investimet klasifikohen në bazë të sektorëve institucionalë siç janë sektori i qeverisë së përgjithshme, autoriteti monetar, sistemi bankar dhe sektorë të tjerë.

Borxhi i jashtëm:

Borxhi i jashtëm bruto është sasia, në një moment të dhënë kohe, e detyrimeve kontraktuale të livruara pezull, të rezidentëve të një vendi ndaj jorezidentëve, për të paguar principalin, me ose pa interes, ose për të paguar interesin me ose pa principal.

Kriteri kryesor për përfshirjen e një detyrimi në borxhin e jashtëm është që ky detyrim të jetë i një rezidenti ndaj një jorezidenti; pavarësisht nëse detyrimi ekziston në vend apo jashtë. Janë përfshirë në borxhin e jashtëm vetëm pjesët e detyrimeve (borxhit) aktualisht të disbursuara, dhe jo ato që mund të disbursohen në të ardhmen.

